

Ecte i vetëm në qytetin që e donte. Ulej në të njëjtat kafene. Nuk hynte në tjetër vend. “Elida”, ku rrinin miqtë e tij të dikurshëm, që i dhanë shpirtë kulturës shqipe të Kosovës, dhe “Edi 2”, ku rrinin miqtë e tij të rinj, që janë shtylla domethënëse të zhvillimeve letrare shqipe në Prishtinë, ishin dy pika ku mund ta takoje mjeshterin e shkrimit shqip, Musa Ramadanin. Kjo ishte gjeografia e tij shpirtërore. Nuk ishte e rastësishme. Kjo gjeografi e tij shpirtërore i bënte bashkë të kaluarën dhe të tashmen e letërsisë shqipe që zhvillohej në Kosovë.

## Lamtumirë, Musa Ramadani —një ikonë e elitarizmit letrar

nga Adil Olluri



### RRËFIMET E MAESTROS

*Dialog me avangardistin  
e viteve '70, Musa Ramadanin*

nga Agron Y. Gashi

Dialogu letrar që nga antika e deri te ai ndërmjet Ecerman-it e Goethe-s, Borges-it e Sabato-s, Marquez-it e Llosa-s, Singer-it e Roth-it është shenjë e kulturës së komunikimit, shenjë dalluese e pajtimit dhe e kundërshtisë.

(fq. 3)

### KREATIVITETI SUBLIM, ADHURIM DHE XHELOZI

nga Minella Aleks

Themi që filan shkrimtar të mbërthen menjëherë si me magji që në faqet e para të librit. Po çfarë është ky “mbërthim”, çfarë është kjo forcë “magjepsëse”, ç’kuptim ka kjo marrëdhënie? Çfarë do të thotë që një pasazh sublim mund të dëgjohet, të shikohet, të lexohet përsëri dhe përsëri me të njëjtën kënaqësi. A ekziston lidhja midis artistit gjeni dhe turbullimeve të rënda mendore?

(fq. 12)

### NDOC GJETJA - “BIRI I GJALLË I NJERIUT”

nga Frano Kulli

Ndodh rrallë, shumë rrallë këto kohë në shoqërinë e konsumit të botës sonë rrokopujë e të garrametëshme që vëmendja publike të ndalojë me vetëndjesi në gjëra të imta eliteqë njerëzimi ka krijuar. Rrallë ndodh që ajo të ravijëzojë a të komunikojë me njeriun e virtytshëm sidomos sot...

(fq. 7)

### SALI SHIJAKU, PIKTORI I VEZËS QË NGA NJË U BË NJËQIND

Ese nga Roland Gjoza

(fq. 5)

Zakonisht një artist nuk rri dot pa një qen. E ka një kostum të mirë, disa miq intimë, ndonjë dashnore të vjetër, për të cilën kujtohet ndonjëherë. Tani e kam fjalën për një piktor. Ai është vërtet i çuditshëm. Tejet i thjeshtë. Dje mbushi 999 vjeç, se ai është si njerëzit e Biblës që jetojnë 1000 vjet, po duket si një djalosh, që sapo është kthyer nga puna, nga një punë e rëndë në fshat duke u marrë me tokën, pemët, kafshët...

### GUIDO CERONETTI

Heshtja e trupit

“Heshtja e trupit” është një libër përmbledhjesh më maksima dhe refleksione të tijat mbi letërsinë, mjekësinë, psikologjinë, filozofinë dhe anatonimë njerëzore, të cilat ai i lidh me një fill që na bën të kuptojmë se cilado prej këtyre fushave, arteve dhe përjetimeve psikike është e lidhur pashmangshmërisht në fshehurazi me tjetrën.

(fq. 11)



### PËRKTHIMET SI FRYMË E KOHËS SONË?

nga Tim Parks

(fq. 14)

### ARTI I PARË

*tregim nga*

Andreas Dushi



### GURI ME FLOKË TË BLERTË

*cikël poetik nga*

Skënder Buçpapaj



MBI ADMINISTRATORIN

E PALLATIT, Z. P. P.

*tregim nga*

Pavlina Pambudhi



# Lamtumirë, Musa Ramadani —një ikonë e elitarizmit letrar nga Adil Olluri

Ecte i vetëm në qytetin që e donte. Ulej në të njëjtat kafene. Nuk hynte në tjetër vend. “Elida”, ku rrinin miqtë e tij të dikurshëm, që i dhanë shpirtë kulturës shqipe të Kosovës, dhe “Edi 2”, ku rrinin miqtë e tij të rinj, që janë shtylla domethënëse të zhvillimeve letrare shqipe në Prishtinë, ishin dy pika ku mund ta takoje mjeshtrin e shkrimit shqip, Musa Ramadani. Kjo ishte gjeografia e tij shpirtërore. Nuk ishte e rastësishme. Kjo gjeografi e tij shpirtërore i bënte bashkë të kaluarën dhe të tashmen e letërsisë shqipe që zhvillohej në Kosovë.

Takimet me të ishin gjithnjë frytdhënëse. Kishe se ç’të mësoje prej tij. Ishte njeri erudit në kuptimin e plotë të fjalës. E njihje mirëfilli letërsinë, teatrin, muzikën, pikturën dhe filmin. Ishte tejet e vështirë ta gjeje një shkrimtar të vlershëm, një regjisor mirëfilli, një piktor të çmuar, një solist të admirueshëm, që të mos ia njihje artin e tij Musa Ramadani dhe të na i shpjegonte veprat dhe krijimet e tij të arrira. Sot rrallë e hiç mund të gjeshe njerëz që jetojnë e frymojnë vetëm për artin, vetëm për fjalën e shkruar bukur, për interpretimin e lëvizjet brilante të artistit të skenës, e vetëm për perfeksionin e vijes së artit piktoral. Thënë nga thellësia e shpirtit, vështirë se sot mund t’i gjeshe të tillët. Lodhesh kot nëse ia ke mësyer ta gjeshe dikë që mund të flas më shumë se dy orë vetëm për artin e bukur. Në këtë kohë të shpërqëndrimit total nga temat e lloj-llojshme shoqërore e politike, ta gjeshe njeriun e tillë është sikur ta gjeshe një diamant të çmuar e t’i lajmërosh njerëzit me gëzim: E gjeta! E gjeta! I tillë ishte Musa Ramadani. Frymonte vetëm për hirë të artit. Ishte keq me shëndet dhe gjithnjë kishte vullnet t’i takonte miqtë e tij të letrave e të fliste vetëm për letërsi. Në këtë aspekt, ai ishte njëri nga mohikanët e fundit. Ikja e tij na duket sikur na është këputur njëri nga penjtë më të rëndësishëm të komunikimit tonë me të kaluarën. Për gjeneratën time të shkrimtarëve, rrëfimi për zhvillimet letrare shqipe në vitet 1970-1990 ishte një histori e bukur suksesi e rilindje e dytë letrare e kulturore e shqiptarëve të Kosovës, Musa Ramadani ishte njëri nga shënjesit kryesorë të kësaj historie. Ai ishte historia që na takonte çdo ditë.

Musa Ramadani ishte një nga ikonat më elitare të gjeneratës së artë të shkrimtarëve shqiptarë të Kosovës, të cilët i dhanë vlerë të shtuar estetike letërsisë shqipe në gjysmën e dytë të shekullit XX. Shkrimtarëve shqiptarë do t’ju mungojë prania fizike e mjeshtrit të prozës e poezisë, Musa Ramadani, ngaqë ai do të jetë mes nesh me veprat e tij të vlershme letrare. Prishtina letrare do të jetë më e varfër pa Musa Ramadani.

Ai ndërroi jetë, por la pas vetes një trashëgimi tejet të vlershme veprash letrare, që do të na flasin edhe shumë e shumë kohë. Veprat e tij të rëndësishme letrare janë: “Mëkatet e Adamit”, poezi, “Thirravaje”, poezi, “Eugjenika e tri deteve”, poezi, “Mëkatet e E(ha) vës”, poezi, “Alfabeti i neurozave”, poezi, “Ligatina”, roman, “Zezona”, “Vrapuesja e Prizrenit”, roman, “Inamor”, tregime, “Antiprocioni”, roman, “Profeti

nga Praga”, roman, etj. Për mua, si lexues i të gjithë korpusit të tij në prozë artistike, ndaj bindjen se kryevepra rrëfimtare e Musa Ramadani është romani “Zezona”. Këtë e them në bazë të asaj se ç’na thotë ky roman e si na e thotë.

Në romanin “Zezona” të Musa Ramadani rrëfihet për aksionin famëkeq të mbledhjes së armëve, që ndodh në këtë kohë, në kohën e Rankoviqit, ndërsa hapësira e rrëfimit është e vendosur në një zonë rurale, në fshatin L., që rezulton të jetë në pjesën e Anamoravës në lindje të Kosovës. Romani i Ramadani na shpalos një tragjedi të një vendi dhe të njerëzve të tij dhe na jep një rrëfim rrëqethës për krajetat nëpër të cilat kanë kaluar njerëzit në atë kohë. Aty rrëfihet se si fshatarët, si viktima të dhunës sistematike, i shisnin të mirat e tyre materiale për ta blerë e dorëzuar armën që u kërkohej, e që ata natyrisht se nuk e kishin. Ramadani, një romancier i nivelit të lartë stilistik e estetik, na tregon se si fshatarët ishin të frikësuar deri në palcë nga terrori i xhandarmërisë komuniste të Aleksandër Rankoviqit. Ata kishin harruar familjet, ekonominë dhe tokat e tyre, duke menduar vetëm se si t’i siguronin armët dhe të shpëtonin nga dhuna që shtoej dita-ditës. Marrë parasysh kohën e shkrimit dhe botimit, padyshim se mund ta cilësojmë si vepër të guximshme letrare.

Ky roman i Musa Ramadani është nga më të rëndësishmit dhe më të realizuarit që është shkruar në Kosovë gjatë viteve ’70 të shekullit XX. “Zezona” është një vepër narrative që i takon modernizmit letrar, me ngjyrim kah rrëfimi grotesk mbi tmerrin dhe frikën kolektive. Te vepra narrative e Musa Ramadani nuk e kemi të theksuar një personazh kryesor, që do të ishte bartës i rrëfimit të ndodhur. Te “Zezona” kemi përballjen e një komuniteti, të një fshati, me terrorin e regjimit.

ADIL OLLURI



Dialogu letrar që nga antika e deri te ai ndërmjet Ecerman-it e Goethe-s, Borges-it e Sabato-s, Marquez-it e Llosa-s, Singer-it e Roth-it është shenjë e kulturës së komunikimit, shenjë dalluese e pajtimit dhe e kundërshtisë. Dialogu letrar është formë sintetizuese e eristikës dhe estetikës, e vizioneve dhe e evoluimit në formë e mendim. Rrëfimet e Maestros është një lloj majeutike për literaturën dhe kulturën, jetën dhe veprën e avangardistit të viteve ’70-të, Musa Ramadani.

Ky dialog nisi në fundverën e vitit 2010, pikërisht atëherë kur po bëhej një dekadë nga njohja me shkrimtarin Musa Ramadani. Ai sapo ishte kthyer nga Vjena, pas një ndërhyrjeje kirurgjike, e cila e kishte molisur tej mase. Zëri i ishte mekur dhe duhej të afroheshe më shumë se zakonisht, që ta dëgjoje më mirë.

Për një dekadë sa e kisha johur, kisha pasur mundësi të bisedonim për çdo gjë që lidhej me kulturën, artin, filozofinë. Për aq sa kisha njohur njerëz të kulturës e të letërsisë, Musa Ramadani ishte njeriu që më së miri dëshmonte për letërsinë dhe kulturën e viteve ’70-të e këndeje. Biseda me të zakonisht fillonte pasdite dhe ndonjëherë zgjaste deri në orët e vona të natës. Kisha menduar që ata dialogë të gjatë e vehementë, siç i quante ai, t’i hidhja në letër, pastaj edhe t’i botoja, porse ishte e vështirë ta bindja.

Megjithatë, bëra hapin e parë. Vendosa ta ndjek modelin e Gustav Janouchit me Kafka-n. Nisa t’i shkruaj ato që i kisha dëgjuar nga ai, i vetëdijshëm se shumë gjëra po mbeteshin jashtë. Fjalët, mendimet nuk e kishin autenticitetin e duhur. Mendimi ishte i tij, por struktura e fjalisë ishte imja. Dialogut i mungonte leksiku i tij plot stilema, figura, lidhëza, folje... I mungonin përsëritjet, ndalesat, kapërcimet, “shëtitjet deduktive”. Thjesht, “gjuha ime”, e vriste mendimin e tij.

Shpejt e kuptova se kjo (s)provë duhej braktisur.

Edhe pse e kuptonte kërkesën time, asnjëherë nuk shfaqte interesim që këtë dialog ta incizoja. Si duket, duke qenë vetë me vite gazetar, e ndiqte sindromi i Marquez-it, sipas të cilit, në momentin që e merr vesh se biseda po incizohej, vihej në pozicion mbrojtës. *Bisedat nuk duhet të regjistrohen, ato duhet të mbahen mend si ai tipi, e për të cilin i ka dalë në krahë Max Brod-i dhe Dora Diamant-i, të cilët komentuan me entuziazëm përshkrimin e Janouch-it.* Në këtë frymë fliste edhe Musa Ramadani.

Sidoqoftë, e bëra timen, i bindur se tashmë raporti ynë miqësor do ta arsyetonte veprimin tim të radhës pa marrëveshje me autorin dhe, autori, miku im do të dorëzohej para qëllimit tim të mirë e dëftonjës për krijimtarinë dhe jetën avangardiste. Mora një diktafon panasonic me kasetë klasike, të tilla që përdoreshin për radio, kur era e avangardës frynte në Kosovë, pikërisht falë Musa Ramadani dhe sivëllezërve të tij. E mbështolla me një letër dhe e vendosa mbi tavolinë, bash afër bllokut të tij përplot me vizatime. Dialogu vazhdoi si gjithmonë. Duke dashur që kjo ta ketë një rrjedhë nga fillimi, ndërhyja shpesh dhe sërish e ktheja në fillim të bisedës.

Atë natë biseda rrodhi deri te dashuria e parë. Pastaj, prapë ishte fragmentar, por pa e humbur fillin e bisedës, fliste për përvoja të ndryshme shkrimi e përshtypje leximi, për përvoja të ndryshme me miq, që nuk ishin më në këtë botë, e që kurrë nuk thoshte se kanë vdekur, por kanë ikur. Tani kisha një problem: ai vazhdimisht fliste për të tjerët, e shumë pak për veten. Në mënyrë që biseda të mos rrëshqiste tej e tutje, mendova që ta ndërroj strategjinë.

\* \* \*

Ishte vjeshtë e vonë. Përveç familjes, askush nuk i gjendej pranë. Tashmë kishte ndërruar edhe vendbanimin. Takimet i bënim te *Aroma 2*, afër Teatrit Kombëtar të Kosovës. Për ta nxjerrë dhe sistemuar bisedën, u desh që vazhdimisht t’i vija kufjet.



# RRËFIMET E MAESTROS

*Dialog me avangardistin  
e viteve '70, Musa Ramadanin*

nga Agron Y. Gashi

Duke qenë se ambienti ku zhvillohej biseda, nuk ishte i zgjedhur, po ishte ai i zakonshmi, ku pinte kafënë e përditshme, dilnin edhe pengesa të tjera. Në momente kur biseda ishte interesante, papritmas dëgjohej zëri i kamarierit dhe i ndonjë klienti që porosiste *makiato pa shkumë*. Pastaj, duke qenë se ishim në një lokal afër rruge, si p.sh. te *Edi 2*, ndodhte që fjalët e tij të mbuloheshin nga zhurma e ndonjë motoçiklete apo edhe mprehja e thikave të skarës, siç ndodhte te *Aroma 2*.

Ai, si gjithmonë, spontanisht dhe me thjeshtësi rrihte tema të mëdha e të vogla. Gjatë bisedave përpiqesha që ai ta nënkuptonte qëllimin tim, që ishte bërë obsesion për të pasqyruar botën shumëdimensionale të tij. Pasi i hodha një numër të konsiderueshëm faqesh në letër, vendosa t'i tregoja se bisedat po i regjistroja. Ai sikur e kishte kuptuar që, gjatë takimeve tona, unë po thellohesha në dialogun që bënim dhe ky dialog po zbardhte qëllimin e që do të gjente mirëkuptim për veprimin tim.

Dhe, miku im pranoi të vazhdonim dialogun, por vetëm me një kusht: Ai të jetë krejt spontan, jo i tipit: *Çka mendoni? Si mendoni?* Ashtu edhe u bë! Tash më duheshin edhe fakte të tjera, dosje, foto, dorëshkrime...

Erdhi edhe dita kur hyra në dhomën e tij personale. Në njërën pjesë, ku bënte gjumin kishte adaptuar shtratin së bashku me tavolinën plot libra, me një çengel përskaaj, në të cilin varte mjetin, që pas operimit

i ishte bërë si pjesë e trupit. Në tavolinë kishte libra rishtazi të botuara, revista, një cigare të trashë sa për ta hequr mallin e saj, fotografi dhe shënime për Kafka-n, disa blloqe të vogla me skica e vizatime të ndryshme, pusulla personale etj. Më ra në sy një skicë e shkruar në një pecetë dyfishe me titull: *Dramë për Sadek Hedajatin*. Një natë më parë kish nisur t'i shkruante edhe faqet e para të dramës Vallja Kobrës, ndërsa si nëntekste pune ia kish vënë dy nëntituj: groteskë dramatike dhe dramë groteske.

Në ballin tjetër të dhomës, në përfundim e sipër kishte një cikël pikturash homazh, që mbanin si nëntituj: *Homazh për Beqir Musliun, Homazh për Teki Dervishin, Homazh për Hida Halimin dhe Homazh për veten*. Duke qenë se pikturat i kishte kthyer kah lindja, dielli ua kishte marrë paksa ngjyrën, edhe pse disa herë i kishte rimbushur.

*- Kjo është një luftë me diellin. Jam mësuar t'i rimbush me ngjyrë. Po kush mund ta luftojë diellin, tha ai.*

Sapo nxori dosjet e dorëshkrimeve, letrat personale të miqve dhe të mikeshave, fotot e të dashurave, skicat dhe romanet në dorëshkrim, papritmas dikush trokiti në derë. Të gjitha i mblodhi shpejt e shpejt dhe bëri se po bënte një monolog për artin e të jetuarit. Kurrë nuk e kam parë të aktronte aq bukur! As në momente më të pëlqyeshme kur zhvillonim dialogun në fjalë.

\* \* \*

Ky dialog nxjerr në pah avangardistin dhe avangardën letrare të viteve '70-të, procesin e krijimit herë përmes thyerjeve të rregullave të zhanrit, e herë përmes reaksioneve gjatë shkrimit për të zbuluar mosmarrëveshjet në mes të krijuesve shqiptarë dhe atyre të huaj, të cilat shihen si shoqërime e afinitete letrare. Në këtë plan rezulton me prurjet e katër brezave letrarë të letërsisë shqipe, të cilët i kishin dhënë mision vetes: të linin gjurmë në të gjitha zhanret letrare. Misioni i tyre nuk nënkupton letërsinë misionare. Sidoqoftë, duhej të ndiqej një rrugë. Dhe rruga e një avangardisti, nuk ishte e lehtë. Kjo dëshmohej edhe nga rrëfimet e avangardistit tonë, pas të cilit vijnë libra, mëkate dhe neuroza, burimi i të cilave më shumë se letrar është jashtëletrar.

Ky dialog është njëkohësisht evokim dhe provokim, sidomos kur Ramadanin rrëfen për peripecitë e botimeve, recensentët, redaktorët dhe censorët letrarë, për skenat dhe prapaskenat e njerëzve të letrave, të politikës dhe ndërhyrjet në botime. Në një kohë neurozash dhe mëkatesh, siç thotë edhe ai vetë, letërsinë e kishte strehë, lutje dhe shpëtim. Prandaj, rrëfimi për detajet e dorëshkrimeve, leximin dhe rileximin e tyre, për situatat, fenomenet psikologjike që ndodhnin gjatë dhe pas aktit të shkrimit, për personat realë dhe personazhet fiksionalë, dashuritë dhe përkushtimin ndaj tyre është më i ndjeshëm.

Ajo që e bën rrëfim tipik prej avangardisti është dialogu për skemat e shkrimit automatik, lëvizjet, 'shkollat' letrare e artistike, jo vetëm në letërsi, por edhe në muzikë, pikturë dhe teatër.

Modeli i tij prej avangardisti shpërfaqet edhe kur flet për romanin modern dhe modernizmin, për romanin me komponentë të avangardës, për modele të megaromaneve moderne dhe atyre postmoderne, që kanë bërë kthesë në letërsinë shqipe dhe atë botërore.

Prandaj, pas një përvoje të gjatë leximesh e krijimesh është e natyrshme që të ketë krijuar filozofinë autentike-personale, *verreleizmin*, që asocon me rrymat letrare franceze, sprovë kjo për një manifest letrar, estetik, *intermedial*. *Verreleizmin* e koncepton si proces, si shenjë, brenda të cilës ka *shenjuesin* dhe *të shënuararin*, një filozofi që nis e mbaron te vetja. Musa Ramadanin, hiç më pak nuk është njohës i teatrit, i kinemasë, i pikturës dhe i muzikës. Ai ka shkruar dhe inskenuar drama për teatër, ka shkruar për kinemanë, ka pikturuar, madje edhe ka kompozuar pjesë muzikore! Në këtë dialog, pa fije hezitimi rrëfen për lidhjet e tij me teatrin e kinemanë, për shfaqjet e hershme dhe censurën ndaj tyre, për shkrimet dhe interpretimet e para rreth shfaqjeve më të mira të viteve '70-të e këndeje. Mbi të gjitha, për rëniet dhe







ngritjet e Teatrit të Kosovës. Ai nuk ndalet këtu, shpjegon lidhjet e letërsisë me filmin, duke zbërthyer ngadalë e bukur elementet filmike në një vepër letrare. Në të njëjtën kohë, ai pikuron me fjalë portretet e piktorëve të mëdhenj, si: Pablo Picasso, Jorge Break, Jackson Pollock, Ibrahim Kodra, Abedin Dino, Çatin Saraçi etj.

Shpesh retrorrefimin e shoqëron një neurozë e madhe, e cila edhe e lindi librin poetik Neurosis, për pretendimin për t’u shndërruar në një tip të heroit sipas frymës së rock-ut me moton: Me vdekë i bukur dhe i ri. Prandaj, nuk është i rastit rrëfimi për muzikën dhe artin e kompozimit, për këngë dhe të papriturat e festivaleve të ndryshme, për shenjat mistike të muzikës dhe lidhjen e saj me arte të tjera, për kompozitorë dhe vepra të mëdha e miniatura, për Vangelis-in, Bach-un, Vivald-in dhe Adagio-n e Albinion-it, himnin e humbjes së tij...

Ky është dialogu i vërtetë me autorin. Dialogu me veprën ka kohë që ka marrë udhën e vet. Por, ky dialog mund të merret si plotësim i veprës së tij, e cila hapur e pret lexuesin e saj.

E pranoj, ky dialog më mirë do të ishte të botohej pas ikjes së tij, kërkesë kjo edhe e vetë Musa Ramadanit, por kisha para vetes dy arsye të mëdha: e para, ky libër botohet me rastin e 70-vjetorit të lindjes dhe, e dyta, botimi fashit paragjykimet e mundshme, që autori i këtyre radhëve mund “të ketë vënë dorë” në mendimin e bashkëbiseduesit të tij.

Krejt në fund të këtij fillimi, i bindem edhe më shumë fjalës së Borges-it se *dialogu qenkësh një lloj letrar, një mënyrë e tërthortë të shkruari*.

Dhe jo vetëm kaq, një konfesion i përjetshëm i autorit. Për këtë i jam mirënjohës mikut tim të shtrenjtë, shkrimtarit Musa Ramadani.

**Agron Y. GASHI**  
Prishtinë, shtator 2014

### Mes krijuesve më të vyer të letërsisë sonë

Me hidhërim të madh e përcolla lajmin e ikjes nga kjo jetë të shkrimtarit të njohur Musa Ramadani. Emri i tij fillimisht më është bërë i njohur e i dashur si përkthyes i romanit të mrekullueshëm “Bufi i verbër,” më pas pata kureshtjen e përherëshme për ta lexuar si autor librash me poezi, tregime, romane deri në lbrin e fundit - përshpirtje, manifest e testament vetjak njëkohesisht “Profeti nga Praga.” Padrejtësisht, në Shqipëri emri i tij nuk ka qenë i lakuar aq sa meritonte të ishte sa u përket institucioneve kulturore-arsimore, qoftë edhe në kuadrin e dikurshëm të letërsisë shqipe

nga Kosova, me sa di unë. Por as ky fakt nuk e zbeh vlerën e vendin e Musa Ramadanit mes krijuesëve më të vyer të letërsisë tonë. “Shkrimi është një gjumë më i rëndë se vdekja,” na kujton profeti nga Prishtina, Musa Ramadani epitafin e profetit nga Praga, Franc Kafka. Fatmirësisht, ashtu është. Dhe ashtu do të ndodhë me shkrimtarin M. Ramadani, si me protagonistin e romanit “Profeti nga Praga”: vdekja e tij do të jetë gjumë i lehtë... Ka lënë pas një tufë librash, përkthimesh, shkrimesh me vlerë artistike të cilat do ta mbajnë mes nesh e brezave që do të vijnë kudo ku shkruhet shqip. Prehje për shkrimtarin Musa Ramadani.

Jetë të gjatë në pafundësi veprës së tij letrare.  
**Virion GRAÇI**

### Musa Ramadani, shkrimtar me stil

Musa Ramadani ishte shkrimtar zotni, shkrimtar me stil.

E kishte stilin e vet edhe kur e ndezte cigaren, edhe kur fliste. Fliste ngadalë, me zë të ulët, me ndërprerje të lehta, si për ta tërhequr më shumë vëmendjen e bashkëbiseduesve.

Kishte një si buzagaz të përhershëm, nga dashamirësia dhe nga statusi, meqë shkrimtarin e konsideronte misionar. Ishte nga pak mistik. Bile kishte raste kur bisedonim edhe për sferën e misticizmit. Në esencë, ishte shkrimtar humanist dhe modernist. Dhe njeri i mirë. Ndërsa vepra e tij letrare gjithsesi është provokuese për lexuesit dhe studiuesit.

Kishte prirje që të eksperimentonte me figurat, me strukturat e vargjeve. Ndërsa në prozë po ashtu ishte kërkues dhe novator. Edhe si gazetar, më saktë kritik teatri, e ka markuar kohën kur teatri në Kosovë kishte njëfarë statusi të artit elitar, kur publiku ishte elitar, kur kishte kuptim të shkoje në teatër e të shkruaje për teatrin. Pra, Musa Ramadani e shenjon një kohë të Kosovës, kur po krijohet identiteti shqiptar i saj në totalitarizëm, por edhe në modernitet.

Musa ishte kontributdhënës në këtë projekt të madh kulturor shqiptar të Kosovës. Bile, vdekja e Musa Ramadanit pothuajse e mbyll ciklin e vdekjeve të shkrimtarëve domethënës të Kosovës, Beqir Musliut, Teki Dervishit, Ibrahim Rugovës, Azem Shkreli, Abdullah Konushevcit, Agim Malës, që në vitet 70 e 80 i dhanë vulën elitarizmit kulturor shqiptar në Kosovë.

**Milazim KRASNIQI**

### Lamtumirë MuRai maestral, Musa Ramadani!

(E fundit shembëllesë e demiurgut)

1. E dha frymën e fundit, në Prishtinë, poeti dhe esteti, dramaturgu dhe romansieri i shenjave/kodeve të shkëlqimit të qytetnimit dardan/arbën. Alkimisti i Dardanisë në modernitet. Iku njeriu që për një vit rresht sa herë dilte për kafe te “Elida” (1999-2000 ku unë isha syrxhynosun në Požarevac, Serbi) i kërkonte Behlulit, të zotit të ëmbëltores, dy kafe espresso t’shkurta, ni për mu e ni për veten, si dëshmi se alkimia e tij evokonte praninë e mungesës. Ishte ‘njeri me hije’ e gjithçka i kishte hije. E njëjhte në thelb dhe me ndjeshmëni të hollë praninë e mungesës, me simbolizmin, që simbas Vincent Descombes - është i rendit të gjuhës - në gjestin e tij, si “institui” i kuptimit, gjë që do të thotë se ai e prodhon kuptimin. (Shih: “Vetja dhe tjetri”, fq. 106;)

2. E pata pà së mrami herë, në dheto, 2016, te taverna “Tirona” dhe nuk kam dashtë me shkue me ia


pa derxhen, sepse due me e pa vetëm n’kambë dhe me e mbajt mend t’ri e të buzëqeshun, mejtues e të thellë, poetik e mistik... Musa dhe Beqa (Ramadani & Musliu) janë përfaqësuesit e magjisë njimtare (realizmit magjik) në letrat shqipe, estetët par exelkence dhe shfaqjet ma brilante e të çuditshme të letrave shqipe të Kosovës, jo vetëm pse dytë e kanë udhërrefyes Sadegh Hedayat-in (Franz Kafken e Orientit), por edhe me figuracion e personazhe nga misticizmi i Lindjes - brenda traditës së islamit shiit, pra brenda traditës së dervishëve dhe filozofisë së dritës (kujto Mëjatet e Ha(E)vës, Destur, Beselam pse me flijojnë, Unë, Halil Garria, Sezam, Shtrigani i Gjell-Hanit...)

**Halil MATOSHI**

### Lamumirë Musa Ramadani!

I hollë, i gjatë, plot finesë; me shkrim aristokrat e me sjellje po aq aristokrate, Musa Ramadanit disa herë i kisha thënë: Musai, ty të vjen shija (era) shkrimtar disa kilometra larg. I pëlqente ky epitete, ashtu siç i pëlqente siç e thërrisja: Musai. -Boll emrin e shkurt e kam. Musa, e njerëzit po ma shkurtojnë e po m’thojnë Mus! Pastaj nënqeshte si përherë. E kisha lexuar qysh si nxënëse, por kur m’i dhuroi dy librat e tij pas një ore letrare në gjimnaz në Pejë: Eugjenika e tri deteve (poezi) dhe Muisiu në Unazën e Inlandit (dramë), lexuar i kam pothuaj të gjitha librat e tij, madje edhe shkrimet në Rilindje, në faqet e humorit në të cilat kishte bërë humor edhe në llogari timen. Brez moshe, brez miqësie e brez krijues me: Beqir Musliun, Ibrahim Rugovën, Teki Dervishin, Ymer Shkrelin..., Musa me shokë i modernizuan të gjitha gjinitë letrare në Kosovë. Jo vetëm krijues i spikatur, por edhe kur fliste për gjëra të zakonshme, ai ishte fisnik, ishte artist, madje edhe për reumën, për fëmijët, për librat e kolegëve. Shpirti i tij i butë, qëndrimi hijerëndë, fisnikria deri në detaje, kujdesi, ndjeshmëria e dashamirësia - të gjitha të natyrshme, rrethuar me vepra plot cilësi, e bënë Musain jo vetëm shkrimtar të pëlqyer, por edhe ikonë aristokracie për Prishtinën. Do të më mungosh shkrimtar, mik; do të më mungosh Musai!

**Naim BEQIRAJ**





Zakonisht një artist nuk rri dot pa një qen. E ka një kostum të mirë, disa miq intimë, ndonjë dashnore të vjetër, për të cilën kujtohet ndonjëherë. Tani e kam fjalën për një piktor. Ai është vërtet i çuditshëm. Tejet i thjeshtë. Dje mbushi 999 vjeç, se ai është si njerëzit e Biblës që jetojnë 1000 vjet, po duket si një djalosh, që sapo është kthyer nga puna, nga një punë e rëndë në fshat duke u marrë me tokën, pemët, kafshët. Në të vërtetë kjo është telajo që rri gjithmonë në kopsht. Ai pikturon në këmbë me gishtërinj. E ka bërë njëherë atë pikturë; peisazh, apo portret, e ka pjekur në syrin e tij prej cigani, siç piqet një frut. Është i zeshkët, shumë simpatik, po ai hiri vulgar fshatarak nuk i ndahet, ai mund të shëmbëllejë më shumë me një kovaç, apo rritës kuajsh, se sa me një piktor. Mban mustaqe si qemoti, nuk ta mbush syrin që di të zografisë, po t'ia thuash këtë ai e pranon. Nuk i ka mbushur syrin as vetes. Ai e ka harruar që është piktor. Sepse çdo pikturë që bën, është si e shpikur atë moment. Gjithmonë ai pikturon si për herë të parë dhe s'ka si të jetë piktor, apo çfarëdo tjetër. Ai është ai, që nuk e njeh se kush është. Ja sekreti, e panjohura. Jepi një rrotë mulliri dhe ai do të merret me të, jepi një kalë dhe ai do t'i bëjë patkonjtë, do ta kashaisë, do t'i flasë, do ta hedhë në telajo. Kjo racë e rralluar është ajo që ne i themi sui generis. Vëre këtë njeri në një sallon mondan, do ta merrnin për karrocierin e pajtonit që pret përjashta, jepini një ftesë për opera, s'do ta pranonin se do të vinte pa kostum, me veshjen e rëndomtë të piktori plot njolla boje dhe kutërbim djerse. Ai i di këto. Nuk merr masa. Rri në këmbë para telajos në kopsht dhe bën me gishtërinj dy gjela që kacafyten. Tufan me pupla, stërpikje me gjak, qiell primitiv, kushtrim i të parëve. Gjëra që s'bëhen më, po ai nuk heq dorë nga gjelat, mullarët, dordolecët.

Gruaja e tij është Ana Maria, italiane. Kur rrëzuan shtatoren e Enver Hoxhes, ai emigroi në Itali. Fjeti përjashta në këmbë në ajrin blu Italian. Kur ishte i tronditur kështu flinte para telajos. I morën në pyetje dhe të gjithë përgjigjeshin se ishin ata që kishin rrëzuar shtatoren dhe e kishin tërhequr zvarrë. Kur i erdhi radha, ai tha se ishte artisti që kishte krijuar atë shtatore. Atij iu dha menjëherë azili politik, ndërsa të tjerët u kthyen mbrapsht.

Kur e çuan pranë fshatarësisë kooperativiste (sot këto gjëra duken shumë banale) ai hodhi në telajo mullarë kashte. Qëndroi disa muaj në Divjakë dhe pikturoi vetëm mullarë. Të gjitha pothuajse i dhuroi, u çmendën pas mullarëve të tij. Nisi grindja sipas posteve, ata që ishin lart i tërhiqnin veshin se Kadaresë ia kishte bërë më të bukur, mullarët e tij kishin dhe hënë. Ato të Dritëroit kishin një gjel të kuq në majë. U detyrua i ziu piktor t'u bënte edhe atyre nga një hënë, yje, gjel mbi mullar, t'u shtonte sasi, po prap se prap, mullarët për pak desh e morën më qafë, se fshatarësia kooperativiste nuk mund të perfaqësohej vetëm me mullarë.



## SALI SHIJAKU, PIKTORI I VEZËS QË NGA NJË U BË NJËQIND

Ese nga Roland Gjoza

Kur ishte i vogël, i ati, një burrë i mirë, po shumë fetar, e ndalonte të vizatonte. Ia griste letrat me vizatime. E kishte gjetur belaja rebelin e pandreqshëm. S'kishte ku të fshihej. Shtëpia ishte e madhe, me shumë kthina, po ai ishte i vogël dhe kishte frikë nga shtrigat dhe lugati. I donte kuajt. I dukej sikur ata e mbronin. Kishte vizatuar një kalë. I ati, që e pa se ku ndodhej, iu afrua pa u ndierë dhe kur pa kalin e vet, u zbut, i tha të bënte dhe një mullar, t'i vinte samar dhe kapistall, të mos harronte të vizatonte dhe një hënë të kuqe, se kali ka shumë mall, gjithashtu e këshilloi ta lidhte kalin te një pemë që të mos ikte, se kushedi zoti i jepte frymë dhe e bënte të gjallë. Pasi u kryen këto të gjitha, i ati dukej i kënaqur dhe i tha të shkonte të flinte.

Kështu u rrit piktori, me gjela, mullarë, kuaj, qen, lopë, hënë, pupla, pemë, bar. E ç'piktor ishte ky i fantaksur, që s'ishte piktor? As një kostum për të qenë, as një kravatë, as një fije seriozitet, po vetem anekdota për të qeshur, një katundar nga Mulleti, që më tepër rrinte andej nga Erzeni dhe grindej me fshatarët, ngaqë bënte zullume kur pinte e kur dilte per gjah. Qeni i tij, në vend që të ndiqte lepurin kishte një zakon të poshtër, futej te shtëpia e Dules dhe i mbyste pulat me gjithë gjel. Fillonte sherri me kushurin, xhaxhallarë, teze e halla, pastaj piqeshin mishra, derdhej rakia lumë dhe këndonin këngët e Hafsa Zyberit. Atje flinte, atje hante e pinte, atje shahej e grindej. Kur vinte në shtëpi, në Tiranë, gjente ftesat, çmimet, pusullkat e parfumuara, pluhurin, vetminë që i mbante mëri.

Aty e pamë, te oborri, kavaleti mënjane nën pemë, në telajo kishte

nisur të merrte trajtë një gjel i egër katundi, nga ata që të nxjerrin sytë. Te furra antike, nën pjergull, atje te kaçubet me trëndafilë stambolli, piqeshin mishra, në tryeza kishte zënë cipë vesa, kundërmonthe jasemin, dera e shtëpisë së madhe tiranase, ndoshta i fundit monument i mbajtur shumë mirë nga i zoti, shtëpia ku vizatoi kalin, rrinte e hapur, brenda ishin pikturat të varura nëpër mure, oxhaku madhështor me shtriga dhe lugatë, masha e gjatë, qeramikat, shkallët, ballkonet prej druri, ai muzg i vjetër që nuk davaritej gjer në fund, qirinjtë me flakë të kaltër, poçet e fenerëve të tymosur, era e vjetër, e papërsëritshmja erë e shpirtit fshatar.

Para derës në mur ishte një rrotë mulliri gjigante, e punuar me dru vidhi. Kishin shkuar deri në Gur të Kuq për atë vidh. Pimë kafe. U futëm brenda dhe pamë pikturat në atë tis të vjetër që s'na ndahej. S'kishte ç't'i bëje, ishin shpirtërat. Bubutonte nganjëherë. Se nga frynte me vizhëllimë. Dëgjoheshin fjalë, të qeshura. Atij s'i bënin përshtypje. Ishte mësuar me misterin. Babai s'i ndahej. Duhani i tij ende kundërmonthe. Nuk e ndiqte më me shkop. Nuk ia griste vizatimet. Vetëm se, herë- herë kur pikturonte ia ndiente frymën te veshi. 19 vjeç ishte kur mori Çmimin e Republikës. Studioi në Akademinë Rjepin në Sankt -Peterburg. Nuk tregon asgjë për pikturën ruse, se e ka mëndjen te prapësitë. Ka qejf të bëjë shaka, të tallet. Ne nuk e dinim atë historinë e gjelave që kishin fluturuar. 120 gjela (120 mijë lekë) kishin fluturuar nga piktura e tij te ajo e Zef Shoshit. Kur të gjithë prisnin që ai të merrte çmimin e madh, ai djall kishte shkuar te portreti i diktatorit, që Zef Shoshi e qante. Kjo


i kishte mbetur në mendje dhe e bënte për të qeshur.

Veç një shkak i vogël duhej, ja kjo rrota e mullirit që ai bohem të merrte rrugën për në fshat, në Mullet. Petrela, kalaja, Erzeni, tyrbja e nuses me duvak. Atje, para se të hyje në fshat, ishte kjo tyrbje me një histori tragjike. Dy karvanë me dasmorë nuk dëgjonin t'i hapnin rrugë njëri-tjetrit, dy nuse me duvak që shikoheshin në heshtje dhe lusnin zotin të zbuste tërbimin primitiv të burrave. Po s'qe e thënë të mbyllej me paqe. Mirë thotë Bim Topalli, se i urti njihet në zemërim.

Ky piktor i çuditshëm ka adhurim primitiv për anonimët. Rrotën e mullirit e ka punuar me aq mjeshtëri Xhepi. Oxhakun e ka bo Rrema. Dyli osht pijetar, Xhafa po bo hurdhën e mullinit, Dari dhe Neri merren me urën, këtu kalon rruga Egnatia.

Kemi mbërritur në fshat, shkelim mbi bar, rrethohemi nga një mjegull vese që davaritet ngadalë. Pamë një lepur që vrapoi në fushë. Dy kuaj të zinj hergele shfrynin flegat, shkroftënin dhe çukërmonin patkonjtë në kashtë. Heshtje dhe qetësi. Ndonjë kakarisje, gugatje, pingërim, bërlykje, po si nga larg. Tym nga oxhakët e nxirë nga bloza, tym plakush i plogët sikur është nisur të flerë. Shkuam te mulliri 200 vjeçar. Trarë, llaç, karro dore. Do të jetë një vend takimi për artistët.

Do të pijmë e do të qeshim, do t'i tregojmë punët njëri-tjetrit, këtu do të hamë e këtu do të flemë, në natyrën e bekuar ku rron bilbili. Pastaj na çoi te një kaçube dhe na tregoi një fole me shtatë vezë bilbili si rruaza ngjyrë gurëkali cigankash. Me një trishtim që nuk i shkonte na u ankua për saçmet që vinin nga pjatela në bregun matanë. Sevdallinjte e Tiranës vinin dhe gjuanin me pushkë pjata fluturuese. Po saçmet, ama, binin ne tryezën dhe kavaletin e piktorit. Po kjo u harrua shpejt, se ai nuk rrinte dot pa u mahnitur si për herë të parë. Në murin ballor të mullirit do të pikturonte nusen me duvak të tyrbes. I shikoni këta masivë prej betoni që i kam vënë në zall për të penguar vërshimin e Erzenit, ndonjë ditë do t'u shkoj daltën, çekiçin, t'i burrëroj e t'i hirësoj, t'i bëj kreshnikë e zana mali. Lumi është skulptor si Rodeni. Shikoni këtë gur që e ka sjellë lumi, a nuk i ngjan ai





mendimtarit të Rodenit, ky tjetri është Pieta e Mikelanxhelos. Merre një copë gur dhe bëje kështu, s'e bën dot. Përvesh fundet e pantallonave dhe futem në lumë, sikur futem në një aneks të Luvrit, Ermitazhit, Metropolitanit. Po lumin po e prishin buldozerët, vinçat, përditë i nxjerrin tabanin hordhitë barbarë të Cingis Khanit... Ç'them, ai s'merrej me lumenjtë!.. Më dhëmb shpirti, nuk hedh gjë në telajo kur fillon shkatërrimin lavatriçja e Erzenit. S'ka më Roden, Mikelanxhelo, po barkaliqë e qafëtrashë, hajdutë me damkë. E vodhën dhe lumin, keni dëgjuar të ndodhin këto rrëtime e shkatërrime në një vend tjetër? Lavatriçja dhe pjatela më trëmbin bilbilat. Këtë nuk e dua. E njihni Tor Lugën? Shok fëmijërie, s' linte dy gurë bashkë. Ju nuk e keni parë ç'ka bërë Tori.

Në një lirishtë buzë lumit ishin ndërtuar me dru të latuar disa ngrehina antike, një bazen, një kopsht

s'kishin fund. O, di unë një të bukur, tha piktori, burri donte të provonte gruan, polla një vezë i tha në mëngjes, por mos i trego njeriu. Gruaja i tha shoqes te kroi, burri im polli dy vezë, shoqja i tha fqinjës, burri i filankës polli tri vezë sot në mëngjes. Puna e vezës u bë tërkuzë dhe burrin e thërret mbreti, i cili është bërë kureshtar dhe do të dijë si i polli ai 100 kokrra vezë. Madhëri, tha provuesi i krisur, bëhet fjalë vetëm për një kokërr vezë, doja të provoja gruan, po se paska mbajtur fjalën. Edhe mua, ia ktheu mbreti, 99 më thanë, po s'di pse i bëra 100. Dhe ai burri, a e dini kush ishte? Unë, tha piktori dhe ia shkrepë gazit.

Ja, pra, ky ishte piktori. Më parë kishte bërë heronj. Ato piktura ekspresioniste, tejet të freskëta, linin mbresa të pashlyeshme. Skemë dhe jo skemë. Kuturisje e përbindëshme për të kthyer një parullë në një vepër arti. Kompozime me një koloristikë të guximshme, gjetje gati biblike në

**!! Ai e ka harruar që është piktor. Sepse çdo pikturë që bën, është si e shpikur atë moment. Gjithmonë ai pikturon si për herë të parë dhe s'ka si të jetë piktor, apo çfarëdo tjetër.**




zoologjik, me kafshë ekzotike të sjella nga jashtë; një kobër pesë-gjashtë metra e përdredhur në trungun e një rrapi, pavoda të mëdha, që të vinin te këmbët dhe kur e kur lëshonin një vigmë të trishtme, deve, mjelma, gjela të egër, pantera, hiena, pëllumba postjerë këmbëlesh e me xhufkë, kuaj, gomarë, struçë. Tor Luga ishte kthyer nga Kanadaja dhe kishte krijuar Eldoradon e vet. Atë ditë, për shpirt të babait, kishte sjellë në restorant 50 pensionistë nga Tirana dhe po u shtronte një drekë falas me fërgesë, bërçolla dhe biftek të skarës. Ai ishte tip më vete. Sa pa piktorin, i la punët dhe erdhi drejt tij, me hapin e shpejtë, i qeshur e i shkujdesur. I kujtoi portretin. Para pak kohësh kishte kërkuar t'i bënte portretin, po çmimi kishte qënë ca i kripur. Donte të dinte pse ia kishte mbushur sfondin me shëgë, hurma, fiq, dardha, rrush. Piktori i tha se ato ishin frutat që kishte vjedhur në bahçen e tij kur kishte qënë i vogël. Prandaj ishte aq i kripur çmimi. Pastaj filluan nga shakatë, ndërsa lavatriçja dhe pjateli me saçmat që vinin dhe këtu, mbetën larg, si një e keqe e lejuar me ligj, që s'kishe ç't'i bëje. Mori kobrën dhe e përdrodhi në trupin e vet. Në Tiranë thoshin se kobra kishte helmuar disa dasmorë dhe vetë pronarin e lokalit. Trillimet

një beze të kuqe ku shkruhej një citat i Enver Hoxhës. Arti i madh mbulonte temën e vogël. Kuturisja e krisur me një mbresë rreziku shndërrohej në triumf magjiplotë. Po ajo kohë mbeti e konservuar në pavionin e Real-Soc të Galerisë Kombëtare të Arteve.

Ai është zhveshur nga malet e rëndë, heronjtë, dhe ka veshur fushën, një palë brekushe të rehatshme fshatari tiranas, pikturon si Ticiani Sebastianon e tij të famshëm, jo me brushë e penel, po me gishtërinj, me një nervozitet dalldisë, gjela që kacafyten, mullarë, dordolecë. Ato janë të perjetshëm, jo si heronjtë që u harruan, se gjithmonë do të ketë mullarë, për të ngrënë lopët në dimër, dordolecë për të trëmbur korbat, kur të piqet gruri në korrik, gjela të kuq si speci, që kacafyten për pulat, që të pjellin vezë me shumicë. Kanavacat e tij ende pa u mbushur, shiten e shkojnë nëpër botë.

Ky është piktori Sali Shijaku, që dje mbushi 999 vjeç, se ai është si njerëzit e Biblës që jetojnë 1000 vjet dhe, kur pyeta për të, më thanë se kishte shkuar për gjah në Mullet. Kishte vrrarë dy lepui rreth 3,4 kg secili, tri mëllenja e dy turtuj. Po une nuk iu besova. Të mos harrojmë se ai është dhe piktori i asaj vezës proverbiale që, nga 1, u bë 100.

## ONUFRİ RİBOTON PAS 23 VİTESH, VËLLİMİN POETİK "LIRIKË ME SHI" TË POETIT AZEM SHKRELI



Ky libër, botuar më parë nga Onufri në 1997, përfshin 95 poezi të shkrimtarit të mirënjohur kosovar, Azem Shkreli.

Së shpejti, Onufri do të botojë dhe veprën e tij të plotë.

**Azem Shkreli** u lind më 1938 në Rugovë të Pejës. Shkollën fillore e kreu

në vendlindje, ndërsa në Prishtinë shkollën e mesme, për të vazhduar Fakultetin Filozofik, degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Për shumë vjet ai ka qenë kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, drejtor i Teatrit në Prishtinë dhe themelues e drejtor i Kosova Filmit. Vdiq në pranverën e vitit 1997.

Ka botuar këto vepra në poezi "Bulzat" (1960), "Engjujt e rrugëve" (1963), "E di një fjalë prej guri" (1969), "Pagëzimi i fjalës" (1981), "Nata e papagajve" (1990), "Lirikë me shi" (1996). Në prozë: "Karvani i bardhë" (1961), "Sytë e Evës" (1975), "Muri i përfundi shqipeve", "Shtatë nga ata", si dhe dramet: "Fosilet" (1968), "Varri i qyqes" (1983), etj. Poezitë e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të huaja. Shfaqja e Azem Shkrelit si poet, përpos që përputhej me ardhjen dhe talentin e tij të fuqishëm, shënonte njëkohësisht kthesën e parë drejt hapjes dhe modernizimit të poezisë shqipe të pasluftës. Shkreli u ngjiti natyrshëm në kulmet e poezisë së sotme shqiptare dhe këtë vend ai e konsolidoi dhe e përforcoi nga njëra vepër poetike në tjetrën.

ISBN 978-9928-313-22-5 | Çmimi 700 lekë | 112 faqe


## Një kryevepër që duhet të jetë në bibliotekën e çdo shtëpie — "Mësimet e historisë" nga Will dhe Ariel Durant

Pasi punuan pesëdhjetë vjet për të përfunduar vëllimet e njohura të "Historisë së qytetërimit", Will dhe Ariel Durant u vlerësuan me çmimin "Pulitzer" në vitin 1968, dhe u nderuan me "Medaljen Presidenciale të Lirisë" në vitin 1977. Përveçse kanë edukuar dhe argëtuar lexuesit në të gjithë botën, ata janë shquar si mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe përkrahës të reformave sociale.

Libri "Mësimet e historisë", një studim përmbledhës i kulturës dhe qytetërimit të njerëzimit, është produkt i punës kërkimore të një jete të tërë nga historianët Will dhe Ariel Durant.

Teksa bëjnë një përmbledhje të filozofisë dhe progresit social, Will dhe Ariel Durant na shoqërojnë në një udhëtim nëpër histori, duke eksploruar mundësitë dhe kufizimet e njerëzimit në epokë të ndryshme. Duke ballafaquar jetë, ide dhe arritje madhështore me cikle të luftës dhe

pushtimit, autorët hedhin dritë mbi tema të jashtëzakonshme, të cilat i japin kuptim edhe historisë sonë.



ISBN 978-9928-265-25-8 | Përkthyer nga Blendi Lami | Çmimi 800 lekë | 128 faqe





Me Ndocin, me 23 tetor 2006, në përvjetorin e lindjes së Fishtës

## NDOC GJETJA - “BIRI I GJALLË I NJERIUT”

nga Frano Kulli

**N**dodh rrallë, shumë rrallë këto kohë në shoqërinë e konsumit të botës sonë rrokupujë e të garrametëshme që vëmendja publike të ndalojë me vetëndjesi në gjëra të imta eliteqë njerëzimi ka krijuar. Rrallë ndodh që ajo të ravijëzojë a të komunikojë me njeriun e virtytshëm sidomos sot, kur hierarkia e vlerave të moralit ka ndryshuar kahje; kur ajo është kthyer thuajse me kryeposhtë e në modë ka dalë e proklamohet si vlerë e çmuar vesi e kur ky “homo sapiens-i” i virtytshëm është specie “në zhdukje”.

Kjo ka ndodhë pardje në Lezhë me poetin Ndoc Gjetja, madje ka ndodhë në një fashio orare krejt në zgript, atëherë kur lajmi se gripi famëkeq *Coronavirus* kisht prekë edhe në Shqipëri. Dhe nuk mënoi dikush të na qortone tek pinim kafe në përmbylljen e veprimtarisë së gjestit se kishim shpërfillur ndalimin e tubimeve...

Ndoci përkujtohet ritualisht prej dhjetë vjetësh në Lezhë, herë në një mënyrë e herë në një tjetër, qyshsekur nuk frymon më këtu në tokë në botën e të gjallëve qysh atëherë kur u nis në amshim në botën e qiellit. Miq të poezisë e miq të tij, ndër to Kujtim Dashi i vetmi jetëshkrues i përimitë i tij, i cili gjithë nektarin e miqësisë me Ndocin e me poezinë e tij i ka përmbledhë në dy librat e tij për Ndocin dhe Preç Zogaj “nxënës”i Ndocit dhe bashkëthemelues me të e me Rudolf Markun e iluminuar heret i “shkollës poetike të Lezhës” të viteve ’80 të shekullit të shkuar ishin aty. Dashamirë të leximit e ushtrues të shkrimtarisë të Klubit të atyshëm të letrave patjetër, por dhe njerëz të hierarkisë zyrtare gjithashtu (dhe kjo është për t’u shënuar...) kanë bërë së bashku vetëvullnets-hëm një gjest për Ndocin. Pardje, në ditëlindjen e tij. Njëra prej sallave të Bibliotekës publike u pagëzua me emrin e tij; salla e librit shqip aty u emërtua “**Salla Ndoc Gjetja**”... Vdekja e poetit është shumë dimensionale, sikundër vepra e tij që mbetet në përjetësi, më kujtohet të kem thënë dhjetë vjet më parë, në qershorin e prushtë e të pikëllimtë të 2010-ës, tek e përcillnim truporen e Ndocit për në banesën e fundit të përjetëshme. Po kam qenë e jam i bindur se, sigurisht që kjo nuk ndodh me të gjithë kumtuesit e shkruarit e poezisë. Kjo ndodh vetëm me poetët, poetë.

-Nëse do të kërkohej një poet i përveçëm në poezinë shqipe, që diti t’iu ikë shablloneve, dogmave, që diti të krijojë një poezi thellësisht të inspiruar, me tipare tokësore dhe qiellore, një poezi që gufon nga ndjenjat e fuqishme të dashurisë, një poezi që komunikon fuqishëm me gjuhën e artit, pa dyshim se njëri nga ta do të jetë Ndoc Gjetja.- shkruante Albert Vataj, in memoriam 5 a 6 vjet më pas.

Ndërsa Pjetër Arbnori i ndjerë edhe ai, do të më thoshte vite më parë: Unë e kam lexuar Ndoc Gjetjen në burg dhe e kam shijuar. Sepse më dukej ndryshe dhe e shijoja... “Ndoc Gjetja në çdo poezi të tij i bie bukur tastierës së humanizmit”, veçon si cilësi Petro Zheji i mençur e i kulturuar. Kurse Ndoci për vehte, përveçse 8 librave vetëm me poezi..., bashkëlidhur me to si në një buqetë të praruar ka lënë edhe të thënë:

“Përherë kam qenë i lodhur nga jeta e përherë i drobitur se kam bërë një jetë me mungesa e privacione të shumta. Por ndjej kënaqësi kur mendoj që unë **nuk e kam lodhur jetën, nuk i kam rënduar asaj për ta përçudnuar**...Jam bërë 60 vjeç dhe akoma nuk e di se ç’është poezia....! Poezia është diçka magjike e cila të mbështjell e s’e ke më veten në dorë, si instrument i saj! Është poezia që të shkruan ty”.

Nuk përmendet ndonjë rast në historinë e larmishme të eksperiencave e jetëve të poetëve, ku poeti dhe njeriu të kenë qenë të trupëzuar, të jetësuar në një si Ndoc Gjetja njeri dhe Ndoci poet. Kushdo e ka njohur e lexuar poezinë e tij dhe më pas ka njohur poetin e ka pasë të pamundur t’i veçojë a t’i ndajë gjendjen dhe qenien (poezinë dhe Ndocin)

Ndoc Gjetja do të mbahet mend si poeti që poezinë e tij e nderi mbi shpirtin e njeriut, ai krijoi një letërsi thellësisht të bukur, të inspiruar nga e bukura. Idetë dhe gjithë bota e ideve për të ishin të njësura me shpirtin. I vetëdijshëm dhe pa kurrëfarë artifici ai na ka dhënë shëmbëlltyrën e përkushtimit të gjithë qenies së tij-poezisë. Poezia e tij buron në zgriptin e privacioneve të pallogaritëshme të jetës fizike....Dhe poezia ka për t’ia shpërblyer me patjetër. Në panteon poetët përcillen nëpërmjet gjesteve...


### EPITAF PËR VETEN

*Këtu prehet ai që quhej Ndoc Gjetja  
i cili pati ardhur gabimisht në botë  
nga vetja e tepruar nxirrte vjersha  
dhe gjithë njerëzit i quante shokë*

*Kur pa që ëndërra kalkulohej me kompjuter  
kur pa se idealet rrëzoheshin në kollltuqe  
kur jepte buzeqëshje dhe merrte skërmitje  
zuri sytë me dorë dhe vendosi të ikte.*

*Dhe shkoi e hyri në manastirin e Unit  
të shpëtonte shpirtin nga gjuhëligat e lehjes  
...Pastaj e përcollen në banesen e fundit  
me shpenzimet falas nga Bashkia e Lezhës.*

*Në çastin e mbramë një hënë e përgjakur  
e puthi në ballë dhe thirri “Nënë”  
Mos kërkonit të dini për të më tepër  
se iku sikur të mos kishte qenë.*





## GURI ME FLOKË TË BLERTË

Askush nuk e di  
As unë nuk e di ku ndodhet  
Guri me flokë të blertë

Nën myshqet e moçme  
Kaptina e tij  
ka vetëm kujtesë

Përtyp ditënatë kujtesën e tij  
Siç përtypet ditënatë  
Nga kujtesa e tij

Reshjet nuk ia prekin kurrë krifën e blertë  
Avullojnë në mes të rrugës

Deri akullanajat në pole  
Kanë vapë prej kujtesës së tij

Është i vetmi blerim  
I përjetshëm  
I përbotshëm

Ahishtet mezi pesin  
t'ia dorëzojnë blerimin e tyre  
dimrit

Breishtat dhe pishnajat  
bredhin horizonteve  
Në kërkim të asaj rrufeje  
Që ua heq qafe blerimin e tyre

Jehonat e kujtesës  
Ia krehin flokët e bukur  
Ia ndajnë në mes  
Ia bëjnë krela

Nëpër jehonat e kujtesës së tij  
ajri kurdis kordat e zërit  
për bilbilat majë plepave

Sa më shumë që zhytet në tokën e zezë  
aq më shumë zhytet në kujtesën e tij të bardhë

aq më shumë ruan në kujtesën qelibar  
kutinë e zetë të kujtesës  
të kushedi çfarë përtejuniversi

Nëse ndonjëherë do të dalë nga toka e zezë  
Guri me flokë të blertë  
Asnjëherë nuk do të dalë nga kujtesa e tij qelibar  
ku është zhytur



## HIJET TONA

Gjithë ditën e lume  
në hijen e qiellit  
Gjithë natën e lume  
në hijen e tokës  
Gjithë jetën e lume  
në hijet e tokës dhe të qiellit

Hijet tona  
Nuk lëmë askënd të na i shkelë



# GURI ME FLOKË TË BLERTË

*cikël poetik nga*

Skënder  
Buçpapaj



## BORA E VJETËR MBI BORËN E RE

Bora e re  
Ndjen ftohtë kur bie  
Mbi lulëzimin  
Që sapo ka dalë nga goxhet.

Ndjen ftohtë kur bie  
Mbi gjelbërimin  
Që sapo ka dalë nga sythet.

Aq sa ndien ngrohtë bora e vjetër  
Nga arkiva qiejsh të moçëm  
Kur bie mbi borë të re  
Qiejsh të rinj.



## NËSE KA DIÇKA PËR T'U HABITUR

Nëse ka diçka për t'u habitur  
Nëse një ëndërr të filluar diku në foshnjërinë e  
vonë  
E vazhdon në një foshnjëri të dytë apo të tretë  
Dmth në pleqëritë e tua  
Dhe nëse e ndërpret edhe amshimin  
Duke bërë një përjashtim që nuk i lejohet  
tjetërkujt  
Për të vazhduar të shohësh të njëjtën ëndërr

E ç'ka këtu për t'u habitur



## NGUJIM NË GUR

Qiejt që lë tek ju ja si ikin me një thikë hënë të  
ngulur në shpinë  
Në këtë natë me hënë shpinëkthyer nga unë, po e  
marr veten time dhe po e ngujoj në këtë gur  
Veshur dhe mbathur larë dhe krehur me  
kozmosin tim  
Me kozmosin tim që nuk e ndaj më askënd që e  
ndaj veç me veten time  
Kjo hapësirë e pafund ishte plot me pritjen time  
Kjo hapësirë e pafund është plot me mua  
Këtu shoh gjithkënd e gjithçka, këtu më sheh  
vetëm Zoti  
Për trup e për shpirt kjo hapësirë nuk më bie  
ngusht as unë nuk i bie ngusht  
Qiejt tuaj ikin askush nuk ua heq dot thikën e  
hënës nga shpina  
Nuk ia heq dot shpinën e therur të këtyre qiejve  
këtij tehu të zi hënë të zverdhur,  
Nuk ia heq dot damarët e prerë të këtyre qiejve  
këtij tehu të verdhë hënë të nxirë  
A nuk duket kjo hënë mbi shpinë të këtyre qiejve  
në ikje si një embrion i dështuar hershëm?  
A nuk duket kjo hënë mbi shpinë të qiejve në ikje  
si një kërmill mbi shpinë  
Guaskash fluturuese?  
Kështu pyes unë teksa ngujohem në gurin tim  
me diell dhe hënë të vetën  
Që lindi njëherë dhe nuk perëndon kurrë. Pyes.  
Kë tjetër?  
Pyes veten time.



## VETËM NJË DRITARE

Vetëm një dritare  
Është vetëm një dritare  
Në jetën time  
Që hapet në balada  
Krrkamash.

Është e vetmja dritare  
Që nuk e hap natë as ditë  
Dhe më vjen keq  
Si kërcunet e shkreta  
Sa herë që ia hedh vështrimet.

Të gjitha dritaret e tjera  
Edhe pa dashur unë  
Hapen në koncerte zogjsh  
Secila në qiellin e vet  
Sa më këngëtar.



## VRAMENDJE SORRASH

Vrasin mendjen  
Janë shartim i korbave me pëllumba  
A janë shartim i pëllumbave me korba

Vramendjet kolektive  
Nuk japin përgjigje kurrë





# ARTI I PARË

## tregim nga

### Andreas Dushi



Tim eti!

#### Një moment i parë

Gjithnjë e kujton mëngjesin e ditës së parë të jetës. Është i bindur se jeta fillon me kujtesën, ndaj harresa dhe vdekja, për të janë e njëjta gjë.

Thonë se është artist. Dhe artisti, sikurse dihet, është *sypatrembur*. Por ai i druhet diçkaje. I druhet shumë!

Gjyshja. Nga ajo mban në mend qëndrimin, syzet dhe fjalët. Edhe mallkimet. Apo mallkimet, fjalë janë? *Intertekstualitet* nuk do të ngurronin t'i quanin teoricientët postmodernë.

“Dhashtë Zoti, të hin vedja në qejf!” ushtonte në veshët e tij, mëngjes për mëngjes, pas lutjes së orës së parë kanonike, e vetmja lutje që thoshte ngase përmbliidhte falënderimin për natën e shkuar dhe kërkesën për lumturi në atë çka do të vinte pas mëngjesit.

Ja, kjo ishte droja e tij: mos do t'i hynte vetja në qejf. Dita kur nuk e përcolli gjyshen deri në kishë të Dielën e Pashkëve pasi donte të pikturonte pulën e bardhë sqepngrënë nga forca e gurtë e grurit, e mbështillte me grinë e pendesës. Po të mos kishte vepruar ashtu, mallkimi s'do të ishte lëshuar.

Në vetvete, ai i druhet edhe drojës. Ndaj, nuk e ndan me askënd frikën e tij. Më mirë të shuhet ndër zjarret e vrullta të mallkimit që ndjek sesa të qetësohet nga kataraktët e qetë që ranë prej syve të gjyshes kur dëshira mos ta kishte shqiptuar atë fjali zuri vendin e çdo arsyeje tjetër për të qarë.

Kakohë që qyteti e sheh me mospërfillje. Dikur, kureshtia qe ulur në fronin e saj të drunjtë. Edhe pse mjekrra vijon t'i varet e parregulluar e shpesh i hy nën jakën e grisur të këmishës apo syzet ngjajnë si t'i kenë zënë ferra ngase ballin e ka gjithnjë të përgjakur, ata të cilët dikur e quanin budalla, tani as që e vënë re praninë e tij. Prandaj edhe ai, përkarshi qytetit ku lindi, krijoi Qytetin ku jeton, plot ngjyra e personazhe të pikturuar bukur.

Qyteti dhe Qyteti qëndrojnë tangjent njëri me tjetrin. Pikëtakimi mes tyre nuk është ai, por *personazhi i ditës së parë*, krijuar prej botës pjesë e së cilës është qyteti në mënyrë të atillë saqë edhe Qyteti i piktorit më realist e besnik, do ta kishte si një banor të idealizuar deri në kufij që kalojnë trillimin.

#### Një moment i dytë

Ishte datëlindja e tij e dhjetë. Familja pati menduar t'i organizonte një festë. Sa e tmerrshme për një artist të ardhshëm!

Trishtimi që mbështolli të tjerët (për të nuk them se ishte trishtim) qe vetmia me të cilën ajo kaloi: asnjë mike apo mik, shoqe apo shok, mace apo qen nuk erdhi të ndante me të arritjen e suksesshme: kapërcimin e pragut ferishte – fëmijë. I vetmi gëzim ishte ati, një burrë shtat'hedhur, me flokë rinor, buzëqeshje çiltërsisht fëminore, lëkurë butësisht të ferishtë dhe mustaqe diturisht të plakura. Ishte burrë i bukur; është burrë fisnik.

Në frymënxjerrjen e errët të luleve ku qirinjtë fikeshin nga erëra misterioze akoma pa u ndezur, rrezatim i vetëm, plot dritë, i gjatë e i hollë, ngjyrë të verdhë në të bardhë kalonte nga buzët në sytë e atit dhe përplasej akullt në ballin e *artistit* që akoma nuk dinte ç'ishte, kush ishte dhe atë ditë thajse u bind që nuk ishte. S'ndjente mërzi, as shqetësim, as zhgënjim, por befasi. Jo pse askush nuk kishte ardhur në datëlindjen e tij, por ngase për të parën herë, pa që nga ati dilnin rreze. Kuptoi se sido të ishte moti, sado të rënda të ishin retë e sado pranë bryma e lagësht e ajrit të shkuar, dielli nuk do t'i mungonte asnjëherë! Shtati i tij fitoi sigurinë, flokët e tij fituan përkëdhelinë, buzëqeshja e tij fitoi buzën, lëkura e tij fitoi ndjeshmërinë dhe mustaqet e tij... Nuk kishte mustaqe atëherë, ishte dhjetë vjeç.

Çastet e kujtesës që solli fragmentimi i asaj dite kalëruan njëri mbi tjetrin si ndër pengesa të buta e ngjitatokase. Dhjetëvjeçarit tani nuk i interesonte më diçka si përvjetori apo dikush si të paardhurit, veç dëshira të ruante çastet në diçka apo diku. Prandaj pikturoi. Atin e tij.

Fitoi vetveten. Fituam *Artistin*.

#### Një moment i tretë

*Artisti* kërkonte mbështetje. Kërkon akoma. Por punë nuk kishte. Akoma nuk ka. Jetonte në provincë. Aty vijon të jetojë. Ku nuk kishte para. Se mos do të ketë ndonjëherë. I duheshin telajo. I duhen, do i duhen gjithnjë. I duhej kryeqyteti. Tani i duhet kryeqytetit. Aq shumë donte. Aq shumë do. Kaq pak duhet! Aq pak mundej. Aq pak mundet. Koha dhe



hapësira thurin një rrjetë ku ai nuk mbështetet dot. Por ati thyen kohën, gris hapësirën dhe nga të çarat që krijohen, rrjedhin mundësitë. Aty mbush gotën me të cilën i biri pi *Vechia* dhe ia jep *Artistit*. Ai as që e falënderon, e shpraz me një të ngritur dhe me arrogancë ia kthen t'ja mbushë sërish. Kur nuk mund të krijojë të tillë çarje, ati është gati të çajë veten, por mundësitë që prej aty rrjedhin janë të pakëta. Ah sa të pakëta!

Zymtësia e *Artistit* nuk zbehet dot me bojërat që errësojnë çeltazi telajot. Vetëm bojërat e atit mund ta bëjnë këtë. Me patjetër, ai do të ishte i gatshëm të mbyllte sytë dhe qenien e vet ta fokusonte te mendimi, të thërriste çdo forcë të hapësirës dhe gjithë ngjyrat e tija t'i mblidhte në pëllëmbën e lugët. Kjo do ta linte të pangjyrë atin, por nuk i interesonte; mjaft që peneli i *Artistit* të prehej qetësisht diku e pastaj të shkunderj butësisht mbi të, birin e tij.

Sikur e gjitha të ndodhte, nuk do të kishte më vjeshtë, ashtu sikurse tani nuk ka për atin. Gjethet, gjithnjë të gjelbra, nuk do t'i binin në truallin e mediokritetit dhe stinët do të harroheshin nga xhelozia. “Mos i lëviz stinët!” lutet heshturazi *Artisti* para kryqeve që ndërton, shenjtërve që pikturon dhe Krishtit që sundon.

*Artisti* e di se një dritë e zbon errësirën, por asnjëherë nuk e ndez. Kur rrethohet prej saj, thërret atin. Edhe në dritë, krijon errësirë veç që të ketë një arsye pse të kërkojë praninë e tij. Ati është ati i dritës, ndërsa *Artisti*, ati i errësirës! Do të tregojë fuqinë e të atit, ndaj e bën. Prandaj është i tillë.

#### Një moment i katërt

Tani që *Artisti* e ka mbyllur një dekadë si i tillë, frikësohet prej plakjes së babait. Dëborën e viteve që i ka rënë mbi mjekërr, ja mbledh me të shpejtë dhe me të, krijon gra prej bore. Tok kërcejnë valse italiane deri kur shkrihen nga nënballi i të atit.

Mallkimin e gjysesh nuk e kujton më. Madje, them se e ka harruar. E di se është babai që e ruan. Ngase *Artisti* gjithnjë ka dashur vetëm t'i ngjaj atij, vetëlavdërimin e mundshëm të së ardhmes e sheh si pasqyrimin e krenarisë dhe gëzimit me të cilin babai tregon për të.

I buzëqeshur, babai pranon arsyetimin e të birit.



Father and son - Stuart Christie





# Mbi Administratorin e pallatit, z. P. P. *tregim nga* Pavlina Pambudhi



**N**a ishte një herë një Administrator i moshuar i një pallati thuajse vërsnik me të. Ofiqin e mbante prej shumë vitesh, pothuaj që nga koha e ndalimit të pijeve alkoolike, dhe ishte mërziur me atë punë. Mirëpo, pavarësisht se Mbledhjet e Përgjithshme të pronarëve përsëriteshin, asnjëri s'ishte dëftyer i denjë për të qenë pasardhës i tij. Është e vërtetë se viteve të para kishin bërë dy-tre përpjekje ta zëvendësonin: herën e parë, me maçokun e tij. Por, fatkeqësisht, pas pak kohe maçoku hëngri një mi, i cili kishte ngrënë helm minjsh, që qëndron, siç dihet, në krye të zinxhirit ushqimor, ashtu si dhe peshkaqeni. Administratori u mërzi, por jo dhe aq shumë. Edhe maçoku e kishte treguar qartë se ishte i paaftë për të mbledhur detyrimet e banorëve.

Herën e dytë pati pranuar t'i zinte vendin një nga pronaret e apartamenteve, e re dhe hiperaktive. Por as me të nuk vajti mbarë, se pas pothuaj 2 ½ muajsh pësoi aksident automobilistik tek ecte me patina. Herën e tretë dhe të fundit banorët vendosën të pajtonin administrator nga jashtë pallatit. I vunë zjarrin vetes. Administratori i jashtëm mori të hollat e depozituara dhe ia mbathi, ndoshta emigrant ekonomik në Zelandën e Re. Ky ters i përsëritur bëri që të qarkullonin thashetheme se ofiqin e administratorit e kishte pushtuar një mallkim, ndaj dhe të gjithë e shmangnin pa e fshehur fare.

Kështu, Administratori i bënte i vetëm Mbledhjet e Përgjithshme, ku merrnin pjesë vetëm bashkëshortja e tij shtratgjërë, Dina, dhe buçja, Foksi – të cilat as nuk merreshin vesh me njëra-tjetrën, as kishin të drejtë vote. U çudit si ia dilte ta zgjidhnin gjithmonë administrator, pasi ai vetë, për arsye deondologjike, nuk e votonte kurrë veten... Pra, detyrimisht qëndroi në pozicionin që kishte, i patundur si shkëmb, dhe vithisej dalë nga dalë, fiziologjikisht, bashkë me pallatin.

Pas vëzhgimeve disavjeçare, kishte dalë në përfundimin se ata të dy (ai dhe pallati), në një farë mënyre kishin krijuar një lidhje të pazgjidhshme. Në funksionet e tyre ishte zhvilluar një lloj koordinimi. P.sh., kur prishej ashensori, edhe Administratori pësonte refluks acidik, dhe e kundërta. Ose, kur u ndërprisnin gazin, se nuk e kishin paguar, Administratori mendohej nga krizat e astmës apo marrja e frymës, kur bllokohej kanali i ujërave të zeza Administratori shkonte për analizat e prostatit – urologu e kishte klinikën ngjitur me hidraulikun – e kështu me radhë.

Meqenëse puna me pallatin – që kishte dhe shumë apartamente – ishte full time job, me



vështirësi u dilte zot detyrave profesionale (ishte antikuar), dhe me më shumë vështirësi detyrave bashkëshortore – për këtë arsye e largëta, por gjithmonë e afërta në distancë, bashkëshortja e tij, tashmë jetonte me urologun. (Natyrisht, për këtë punë nuk e kish fajin vetëm pallati.) Administratori tashmë ishte bërë mizogjin dhe mizofelin (nuk kishte marrë mace tjetër, as grua tjetër), dhe gëzimi i vetëm në jetën e tij ishte kur vdiste ndonjë banor që nuk linte trashëgimtarë.

Atëherë, me pushtetin që i jepte ofiqi dhe çelësi, hynte i pari në shtëpinë e braktisur, menjëherë pas policisë, bënte një vlerësim paraprak të sendeve që kishte lënë i ndjeri dhe transportonte në antikuarin e tij gjithë ç'përbënte interes profesional. (Deri tani kishte marrë dhe përdorur një kolovajze verande *fer forgé* me tre marshe shpejtësie, një frezë dentisti të shek. XVIII, një parzmorë për fëmijë, 13 pulla me vlerë koleksionimi,


dy bufe me shumë vlerë koleksionimi, një nuselale të balsamosur, në gjendje të mirë, tre tablo të *Plakut me llullë* (si dhe një të katërt – një paraqitje e rrallë e vetë plakut në portret me cigare elektrike), një komplet salloni ngrënieje në stil të periudhës së regjencës, me këmbë pantere, një poltronë trikëmbëshe prej lëkure e markës Chip and Deil, si dhe një teneqe vaj.) Gjithashtu, një gëzim të vogël e gjente kur në kohën e lirë studioje çdo farë libri e letre që i tërhiqte vëmendjen. Mendonte se edhe këto diku, dikur kishte për t'i përdorur – pavarësisht në s'i sillnin ndonjë fitim.

Historia e Administratorit përfundoi, siç ishte e natyrshme, bashkë me historinë e pallatit. Gjatë tërmetit të madh të vitit 2028 Administratori ra nga shtrati dhe, me atë rast, u kujtua, befas, se kishte harruar në depon e bodrumit Librin e Praktikave të vitit 1999, dhe iu duk e udhës të hiqej zvarrë deri atje për ta marrë: kujtesa e kishte braktisur tashmë dhe duhej të përcaktonte centimetrat e bashkëpronësisë së pronarit të penthouse-it, i cili kohët e fundit kishte bërë restaurim të paligjshëm të verandës, si dhe të njoftonte MMRRPP-në (Ministrinë e Mjedisit Rregullimit dhe Punëve Publike) dhe Prokurorinë e Shkallës së Parë për rrezikshmërinë e murit lindor të pallatit.

**Përktheu:** Sokol Çunga

\*

**Pavlina Pambudhi** (Athinë, 1948) është prozatore, poete, përkthyes, skenografe, redaktore dhe piktore. Tregimi i mësipërm është shkëputur nga vëllimi i fundit me tregime *Histori të çuditshme dhe shumë më të çuditshme* që pritët të dalë nga shtypi në fundprill të këtij viti nga shtëpia botuese Kaleidoskop, Athinë. Botohet para daljes nga shtypi me lejen e autores.





# Heshtja e trupit

nga

GUIDO  
CERONETTI

Përkthimi nga Rigel Rizaj

*Guido Ceronetti (1927-2018) ka qenë filozof, shkrimtar, përkthyes dhe gazetar. Një nga njerëzit më të njohur në Itali dhe sjellës në gjuhën italiane i “Librit të Jobit”, “Librit të Isaisë”, “Këngës së këngëve”, “Psalmëve” dhe Koheletit” të përkthyer prej origjinalit të tyre në hebraishten antike, si dhe përkthyes prej latinishtes i Horacit, Katulos, Xhovenalit etj. “Heshtja e trupit” është një libër përmbledhjesh më maksima dhe refleksione të tijat mbi letërsinë, mjekësinë, psikologjinë, filozofinë dhe anatonimë njerëzore, të cilat ai i lidh me një fill që na bën të kuptojmë se cilado prej këtyre fushave, arteve dhe përjetimeve psikike është e lidhur pashmangshmërisht në fshehurazi me tjetrën.*

Gjesti më i bukur i huajsisë dhe indiferencës në botën e krishterë ndaj kohës, ndaj zbulesës, ndaj ndjenjave, ndaj riteve të krishtera: ai i një rabini oriental i cili, për Kërshëndella (ditë në të cilën është e ndaluar të lexohet Torahu), priste letrën higjienike për të gjithë vitin. (Rrëfen Kafka).

Një tribu trogloditësh të Filipineve vendos mbi pubis një orkide për të namatisur shterpësinë. Gjethja e fikut të Gjenezës ia mbulon lakuriqësinë që ta mbrojtur ndaj shpitrave të ligj, të cilët pas mëkatit do të sulmojnë njeriun.

Kafka i shkruan Otlës nga sanatoriumi Matliary se ndihet i trishtë “si një hienë” pasi kish rënë pré e tundimit për të ngrënë sardele me patate dhe majonezë, dhe se shihte një hienë tek gjente një konservë me sardele, tek e hapte me putra dhe tek kullufiste kufomat. Vetëm një vegetarian i vërtetë mund të jetë i aftë t’i shohë sardelet si kufoma dhe konservën e tyre si një “arkivol qumështi”; një ngrënës të mishit (nuk më bëhet të them “mishngrënës” pasi njeriu nuk është mishngrënës) edhe sikur ta mbyllin në frigoriferin e një thertoreje nuk do e ketë ndjesinë se po bashkëjeton me kufoma të ndara katërsht.

Andrea Dorin-i pohonte se nuk mundte të vdiste, duke mos qenë kurrë i lindur (pasi kish ardhur në jetë me lindje cezariane). Vrasësi i Makbethit, Makdafi,

nuk është lindur prej një gruaje, dhe duke ia ngulur tejpërtej shpatën Makbethit, i rrëfen se ka ardhur në jetë me lindje cezariane. Na ka shpëtuar një ide e thellë: barku i ngjizur nuk është grua, ka një njeri por nuk ka një lindje, ai njeri i lindur ka për të qenë i paplagosshëm, me gjasë i pavdekshëm. Gruaja shihet tek vagina, dhe nëse nuk lind prej aty, ku gruaja banon, mëma (mitra) që të ka nxjerrë në jetë nuk është mëma jote dhe nuk i përket mëmës sate. Me lindjen cezariane të kthyer në praktikë të kohëve të fundit, shpejt do të kemi mes nesh njerëz të hiç-lindur sesa të lindur. Natyra e përballonte mirë përjashtimin, por mundet të vërë rregull, apo thuajse? Thonë “ime më”, edhe pse janë fëmijë të ardhur me lindje cezariane, por ka më pak dashuri birnore dhe më pak mëmësi në ekzistencën e tyre.

Albert Camus thotë për Jean Guitton-in: “Ai është nga ata që nuk kanë vrarë kurrë një mizë”. Përgjigjet Guitton-i: “Miza që ai nuk e vrau, gjetiu solli murtajë”. Lipset të quhet plesht, sesa mizë, ama e vërteta morale qëndron.

Optimizmi është si oksidi i karbonit: vret duke lënë tek trupat një gjurmë trëndafil.

Kafka i quan rrotullat e Torahut “kukulla të brishta pa kokë”, por e ndjen thellësisht *mitzà*-në e krijimit. Hebreu që nuk e përmbush atë është vetë një kukull pa kokë; por edhe më tepër është Hebreu që nuk beson në Zot.

*Komedia* si alegori e Tretjes: “Hiqni dorë prej çdo shprese” ( i thotë Goja ushqimeve); djaj, Lugje (stomaku, “trastë e trishtë”, domethënëse kjo “e trishtë”, zorra e trashë); “ngushticë e rrumbullt”, “të shohësh sërish yjet” (anusi). *Purgatori*: ç’është mbledhur prej thelbësore mbetet në trup për të vuajtur. *Parajsa*: udhëtimi nëpër lëndë përfundon, ajo që i përkiste Dritës u kthye te Drita; nis sërishmi kalvari për një tjetër ushqyerje.

Vendet ku mban më shumë erë janë vendet ku mblidhet më tepër shpirt. Syri, i cili nuk mban erë, është një *pasqyrë*, jo një shpirt. T’i shtosh aromëra trupit, është si t’i shtosh atij shpirt ose të hiqesh sikur e ke një të tillë, në rast se ajo mungon. Erërat shumë të forta janë bërë të papëlqyeshme, pasi tepria e shpirtit është e patolerueshme në masë, pasi shtazëria natyrore është shtypur dhe frenuar prej qytetërimit.

Hidra e *Lezbos*. Mjafton një gabim tipografik për të fshirë një mit dhe për ta zëvendësuar me një moral.

Horaci kish shikim të dobët (*lippus*), Virgjili kish probleme me tretjen (*crudus*). (Po as Horaci nuk kish një stomak të shëndetshëm). Hermann Broch-u thotë (*Der Tod des vergil*) se Virgjili vdekatar ish një Bimë Vegetuese; kish shpëtuar prej stomakut të sëmurë. Të shndërrohesh në bimë është më mirë sesa të shpërndash te vdekja aromën e shenjtërisë.

Pasioni i Moxartit për skatologjinë, erotizmin, gjuhën e ndyrë, vrazhdësinë gjuhësorë. Kish disa rezerva të errëta, një Ferr të vetin prej tingujsh të papastër që, te Dhoma Angjelike e tij, e shndërronte *nigredon* dhe *albedon* e tij në përsosje hedenike.

Një dëshmi e injorancës së filozofëve është fakti se nuk e konsiderojnë kurrë gojën si organ dëshirimi.

Një njeri që lëvdohet është një njeri të cilit i janë hedhur zinxhirët.

Një mendim tejet i bukur prej Le Clèzio-së: “Me gjasë, një ditë do të mësojmë se nuk bëhej fjalë për art, por për mjekësi”.

Charles Du Bos-i vëzhgonte se përshkrimet psikologjike të Dostojevskit të shpien në hamendësi të një bashkëpunimi të drejtëpërdrejtë me Satanain.

Ekziston një spermë psikike, thotë Paracelsi, e sekretuar prej trupit qiellor, krijues i maktheve dhe i nënshtrimeve. (Lilithi mbarset psikikisht).

Zola, tek *Nana*, thotë se kur zhardhokët dekompozohen, marrin një aromë njerëzore. Ama kur njeriudekompozohet nuk merr aromë zhardhoku.

“Cila është më e mira? Të argëtohsh me Kërpudhat apo të të vijë keq për Ideologjinë?”, e pyetën Aldous Huxley-n, - i cili zgjodhi kërpudhat, - në “Newsweek” më 9 maj të 1966-s. Zgjedhje më racionale është që lipset t’u ikësh kërpudhave si ideologji, apo ideologjisë si kërpudha. Nuk na volit asnjë drogë.





# KREATIVITETI SUBLIM, ADHURIM DHE XHELOZI

nga Minella Aleks

Themi që filan shkrimtar të mbërthen menjëherë si me magji që në faqet e para të librit. Po çfarë është ky “mbërthim”, çfarë është kjo forcë “magjepsëse”, ç’kuptim ka kjo marrëdhënie? Çfarë do të thotë që një pasazh sublim mund të dëgjohet, të shikohet, të lexohet përsëri dhe përsëri me të njëjtën kënaqësi. A ekziston lidhja midis artistit gjeni dhe turbullimeve të rënda mendore? Në jetën e shoqërisë çfarë përfaqësojnë individualitetet e spikatura, këta “magjistarë” me kreativitet gjenial? Përse forca krijuese është shumë më e fuqishme sesa frikërat e përditshme? Këto e të tjera pyetje do përpiqem të shpjegoj më poshtë. Mbi të gjitha si në çdo marrëdhënie njerëzore është autori së pari ai që e kërkon dhe e fillon një marrëdhënie me audiencën.

“Mbërthimi si me “magji” i detyrohet atmosferës që frymëzimi artistik i shkrimtarit krijon në imagjinatën e lexuesit. Me fuqinë goditëse të fjalës shkrimtari i “injekton” lexuesit një ndjesi emocionale që ai vet e ka përjetuar në imagjinatën e vet dhe, në këtë mënyrë e “shkund” nga përgjumja, i stimulon dhe eksiton fuqishëm ndjenjat e lexuesit duke e zhvendosur atë emocionalisht në situatë ankthi, tmerri ose ngazëllimi ekstazik. Atmosfera të cilën autori e projekton si imazh është motori që ose na lëviz nëpër faqet e librit ose na bën që të ndalojmë leximin. Ose na përfshin ndjesia e fuqishme e pëlqimit të fjalëve ose jo. N.q.s. atmosfera nuk korrespondon me pritshmëritë e lexuesit ky e humbet interesin. Atëherë autorit, marrëdhënia e kërkuar i refuzohet prej lexuesit. Shkrimtarët më të mirë janë të aftë që të tregojnë një histori e cila simulon në fantazinë e lexuesit një imazh real të shprehur qartë. Ky simulim imazhi lehtësisht i kuptueshëm ka koherencë logjike të shkëlqyer nga përdorimi i fjalëve që janë të lidhura thellë me shqisat njerëzore, fjalë që, fjalë për fjalë “vijnë në jetë” në mendjen e lexuesit.

Shkruar ndoshta në shekullin e parë pas Krishtit, traktati “Sublimja” (traktat i estetikës dhe kritikës letrare) botuar më 1554 si përkthim i bazuar në origjinalin e shek.10të, në vlerësimin e shumë kritikëve letrarë dhe historianëve për nga rëndësia renditet i dyti pas “Poetika” e Aristotelit (rreth 335 para Krishtit). Ka një autor të supozuar të “Sublimja”, i ashtuquajtur Dionysius Longinus. Longinus e përkufizon sublimitetin (hypsos grek) në letërsi si “jehona e madhëstisë së shpirtit”, domethënë fuqia morale dhe imagjinare e shkrimtarit që përshkon një vepër. Kështu, për herë të parë madhështia në letërsi i atribuohet cilësive të lindura te shkrimtari. Qëllimi i tij ishte të trajtonte në mënyrë të qartë, logjike, bindëse dhe të pakundërshtueshme rëndësinë e mendimeve dhe të ndjenjave madhështore, të gjuhës dhe të strukturës në poezi.

Në teorinë estetike dhe letrare sublimja si nocion është një madhështi goditëse e mendimit dhe e emocionit, përsosmëri në gjuhë”, “shprehje e një shpirti të madh” dhe fuqi kreative për të provokuar “ekstazë”. “Sublimimi” thotë Longinus, i krijuar në momentin e duhur shkakton një tronditje emocionale ekstreme e krahasueshme me ciklonin tropikal apo vetëtimat qiellçarëse përpara stuhisë. Kjo ndoshta është ajo që disa shkrimtarë e quajnë “shkëlqim, rrezatim ekstazik mrekullor” e që disa të

tjerë preferojnë emërtimin e dijetarit grek “sublimim”. Longinus i drejtohet lexuesit: “A e shihni, miqtë e mi, sesi Herodoti gjen si suport mental një moment angështie në mendjen tuaj dhe e drejton atë nëpër vende interesante dhe bën që ju të shihni vetëm atë që dëgjoni. Longinus besonte se “Shkrimi i shkëlqyeshëm nuk ka qëllim që ta influencojë lexuesin për të ndjekur një bindje. Përkundrazi e largon lexuesin nga vetvetja, nga bota e anktheve dhe shqetësimeve të brendshme dhe me atmosferën goditëse të përshkrimeve e të ideve e komandon vëmendjen e lexuesit, i zbulon atij papritmas një shteg që e nxjerr nga burgu i vetvetes”.

Në veprën e tij “Sublimja” Longinus e kupton “Madhështinë artistike” si një kreativitet estetik racional i bazuar në pesë burime: 1.Fuqia imagjinate e jashtëzakonshme,, 2. mendimi instiktiv me fuqi të madhe inspiruese, 3. mendime dhe shprehje të figurshme të nivelit të lartë, 4. elokuence aristokratike dhe 5. virtuoizitet për të krijuar një frazë të një ekuilibri sintaksor të shkëlqyer. Dy të parat i konsideronte kapacitet natyral biologjik, talent i lindur ndërsa tre të tjerat kapacitet artistik, përkatësi e zëjtariisë së krijuesit. Në mesin e shekullit të tetëmbëdhjetë estetët e përkufizuan artin sublim si, më të fortën ndjesi emocionale nga nxitja e një efekti artistik që i referohet një madhështie estetike përtej të gjitha mundësive të llogaritjes, të matjes ose të imitimit.

Të tjerë e konsideronin sublimimin si një emocion absolutisht të shkëlqyer, në kuptimin matematikor përtej çdo krahasimi të një madhësie të pafund dhe në kuptimin dinamik të një fuqie të pakufishme.

Sipas Frojdit procesi kreativ që njeriu e ka dhuratë nga natyra është një alternativë, një mundësi zgjedhjeje përkundër neurozës, dhe që për artistin vepron si një mekanizëm mbrojtës nga neurozat, duke çuar kështu në krijimin e vlerave artistike për publikun. Kreativiteti ka aftësinë t’i shndërrorë fantazitë e artistit në krijime artistike, në vend që t’i paraqesë ato si simptoma neurotike. Në ndryshim nga Frojdi, i cili mendonte se gjithçka kishte të bënte me libidon seksuale, Jung mendote se ishte më shumë diçka mistike. Jung nuk e konsideronte sublimimin një kanalizim vullnetar dhe të detyrueshëm të instinkteve në një fushë false aplikimi. Ai e përcaktoi sublimimin si një produkt artistik të emocionit më të fortë që mendja është e aftë të ndiejë. Qoftë ky një emocion tmerri ekstremisht i dhembshëm, qoftë emocion ekstremisht ngazëllyes. Jung njohu dhe vlerësoi potencialin transcendent të psikikës si diçka misterioze.

Ka pasur edhe një arsytim më specifik i cili i përmbahej idesë se vetëm krijimtaria në artet e bukura, në letërsi, në pikturë dhe në muzikë përbën kreativitet sublim, madhërisht hyjnor. Sipas këtij opinionit shkencëtarët e mëdhenj nuk janë në nivelin e gjeniut të arteve të bukura, sepse ata ndjekin procedurat e përcaktuara të metodës shkencore të paraardhësve në vend që të rikthehen në imagjinatat e tyre. Mendoj se ky diferencim është mjaft intrigues dhe mjaft mirë arsyetuar ngaqë një formulë apo një shpikje fizikë apo në matematikë vërtet është produkt i një mendje brilante por kuptimi i qartë dhe emocionet e saj mbeten aftësi e vetëm pak personave edhe pse dobia për shoqërinë

është shumë e madhe. Shpikja në shkencë është kreativitet gjenial që nuk përmban transcendencën, lartësimin hyjnor, nuk e “ngjall të vdekurin” sikurse muzika, nuk e përmban fuqinë e “fjalëve që e lartësojnë mendjen dhe e nxjerrin njeriun jashtë vetes”. Formula e relativitetit është emocionalisht “e ftohët në madhëstinë e vet universale”, Vet Ajnshtajni e përshkruan relativitetin si “mendimin e tij më të lumtur”, por që sigurisht mbetet si i tillë për shumë pak njerëz të shkencës, Artet kanë vendin e ‘mbretëreshës” edhe në radhën e publikimit të çmimit “Nobel”. Mbas mjekësisë dhe shkencave ekzakte ankthi më i madh kulmon me çmimin e letërsisë e më pak me atë të paqes. Edhe Isaac Newton, të cilin Kanti e quante “njeri i madh i shkencës”, prej atij vet nuk konsiderohej se ishte një gjeni i kreativitetit hyjnor.. Pikërisht për këtë arsye, nuk ishte as vetë Kant!

Madhështia e artit nuk është të gjejë dhe të përshkruajë atë që është e zakonshme, kërkon dhe përshkruan atë që është unike.

Kreativiteti i madhërishtëm nuk është sinonimi i origjinalitetit, i produktivitetit, i spontanitetit, i një njeriu që jep një zgjidhje logjike të problemit, apo i një artizani produktiv në seri, edhe pse shpesh termi kreativitet përdoret reciprokisht duke mos qenë i barasvlefshëm.. Një piktor mund të jetë origjinal por jo kreativ, një i arsimuar në letërsi mund të jetë produktiv por qartësisht jokreativ, etj., etj..

Psikiatri i shkollës mjekësore të Harvardit Albert Rothenberg i cili u dallua në gjithë jetën e tij profesionale për studim të thelluar të procesit kreativ ka meritën e shpjegimit të një procesi veprues përgjatë akteve të krijimeve sublime, krijime që për kohën kur ndodhin përbëjnë një ide, një formë dhe një përmbajtje të re dhe së dyti me konsensus konsiderohen si vlera që shtrihen për një periudhë kohe pa limit. Bëhet fjalë për proces krijues mendimi që bazohet në nocionin e kundërshtive strukturore dhe që përfshin në vetvete zhvillimin e njëkohshëm të të kundërtave përgjatë kreativitetit sublimues. Fillimisht e quajti “të menduarit kundërshtues”, aftësi për të konceptuar dhe përdorur në mënyrë të njëkohëshme dy apo më shumë ide, koncepte apo imazhe kontradiktore. Rothenberg e zëvendësoi fjalën “kundërshti” me fjalën “Janusian” sepse më saktësisht kjo e dyta përputhet me simultanitetin, njëkohësinë e “kundërshtive” por edhe sepse si metafor mishëron simbolet që tregohen në imazh. “Janusi” ishte Hyji romak me dy fytyra që shikojnë njëkohësisht në dy drejtime të kundërta. Më së shpeshti operativ në fazën e hershme ose të frymëzimit të produktit krijues. Proçesi “Janusian” është tipar dallues i mendjeve me kreativitet artistik brillant ngaqë kanë aftësinë e jashtëzakonshme që arrijnë të shohin lidhje të pazakonta në situata të zgjidhjes së problemeve, gjë që u mungon njerëzve të tjerë.

Në librin “Kohë e Pamjaftueshme” Helena Kadare zbulohet si një vëzhgues shumë e hollë kur sjell një konstatim shumë interesant që lidhet me procesin Janusian. Ja sesi e shpjegon bashkëshortja e shkrimtarit në libër: “Is. të cilit i qëllonte që në çaste zemërimi të kapte në mënyrë të rrufeshme gjëra që do t’i duhej ndoshta shumë kohë për t’i kuptuar më tha se, në atë përgjigje cinike (të Javer Malo) atij iu zbulua lakuriq gjithë hipokrizia dhe qëndrimi me dy faqe i zyrtarëve shqiptarë ndaj këtij libri....”. Ilustrimi shumë i qartë i simultanitetit të të kundërtave, si të shikosh në copat e një pasqyre të thyer.

Rothenberg na bën me dije se të gjitha llojet e të menduarit kreativ sipëror zakonisht ndodhin brenda një kornize racionale të vetëdijshme të menduari dhe jo në një gjendje të ndryshuar ose të



transformuar në mënyrë mistike.

Psikiatri Rothenberg konstaton se larg të qenurit burim ose kosto e kreativitetit, psikozat dhe format e tjera të sëmundjes mendore janë në të vërtetë pengesa për punën krijuese. Krijuesit poet që ndërkohë mbartin dhe manifestojnë turbullime mendore dallohen për egot e tyre marramendëse, të cilat i shtyjnë ata që të mendojnë se poezitë e tyre janë aq personalisht vetë-shprehëse sa sipas atyre në poezinë e vet nuk mund të cungojnë asnjë fjalë të vetme pa rrezikuar të shpërbëhen. Ata duket se thonë: “merre ose lëre, kjo poezi është unë. Në asnjë mënyrë nuk do ta ndryshojë”. Që psikozat influencojnë në krijimtari në mënyrë penguese ilustrohet qartësisht edhe nga rasti i ndikimit insistues të Ezra Pound mbi Thomas Eliot për gjendjen e dobët të draftit të parë të poemës “Territori i mbeturinave”. Thomas Eliot nuk dallohej për “ego marramendëse psikotike”. Kjo bëri që të ishte i hapur, i gatshëm për ta rishikuar poemën sipas këshillave të mikut të tij Ezra Pound. Pasi e ripunoi poema me rreth 800 rreshta u njoh dhe u vlerësua si një nga më të rëndësishmet e shek. të 20të. Gjeniu dhe krijimtaria artistike e shkencore jo vetëm në mendësinë popullore por edhe në mes të njerëzve të fushave të ndryshme profesionale konsiderohen prej kohësh të lidhura shumë me çrregullimet apo deviacionet psikopatologjike. Një numër i madh i sjelljeve jo të zakonata-devijante, duke filluar nga ekscentrizmi i butë e deri tek psikozat e manifestuara, jo vetëm që pranohen si diçka e natyrshme te ata me kreativitet te lartë, gjë që nuk habit, por shpesh janë aq të pritshme sa mos shfaqja te këta persona përbën habi. Të shumta janë anekdotat për veprimet e çuditshme të njerëzve të mëdhenj, mbushur me imazhe të shkencëtarëve, artistëve dhe poetëve të “lajthitur”, “të fandaksur”. Mendimtarët e Greqisë së lashtë e mendonin frymëzimin poetik si një formë të çmendurisë hyjnore ndërsa Aristotelit i dedikohet thënia se “asnjë gjeni nuk ishte pa një përzjerje të marrëzisë hyjnore”. Kriminologu Cesare Lombroso, shkroi traktate të gjera që lidhin gjenin dhe krijimtarinë me marrëzinë. Por a ka prova bindëse apo studime mbështetëse mbi këtë tezë? Dokumentacioni i kujdesshëm historik dhe epidemiologjik i incidencës së turbullimeve mendore te njerëzit që shkëlqejnë në nivelet më të larta të kreativitetit artistik tregon se përgjatë gjithë historisë njerëzore ka një numër shumë herë më të madh të individëve pa sëmundje mendore. Psikiatrit konstatojnë se ka një element të përbashkët si faktor kryesor që ka çuar në besimin e gabuar se, ka një lidhje midis kreativitetit artistik dhe sëmundjeve



mendore, pikërisht anormaliteti apo shmangia ndonjëherë mjaft ekstreme në jetën e përditshme e të dy subjekteve nga mënyra e zakonshme e të menduarit dhe e sjelljes normative e shumicës së njerëzve. Simptomat e sëmundjes mendore bëhen mënyra stereotipe dhe shpesh banale, janë të pavullnetshme, pa bazë gjykimi dhe të pa orientuara drejt një finalizimi, (të menduarit divergjent) ndërsa produktiviteti i artistëve krijues është i qëllimshëm, drejt një zgjidhjeje të vetme korrekte dhe euforia rezulton pothuajse gjithmonë nga një arritje e jashtëzakonshme, (të menduarit konvergjent). Gjenitë në mënyrë specifike mendojnë në mënyrë jashtë të zakonshmes për të krijuar ide dhe produkte të reja jashtë rendit të zakonshëm të shoqërisë. Në çdo rast kur nga studiuesit bëhet pyetja nëse ekziston lidhja midis sëmundjes mendore dhe gjeniut artist sillet si shembull piktori Vincent van Gogh dhe matematicieni John Nash. Ata që e pranojnë lidhjen midis gjeniut dhe sëmundjeve mendore çuditërisht harrojnë apo nuk marrin në konsideratë një fakt që dihej që gjatë kohës kur piktori i madh ishte gjallë.

Prindërit Van Gogh kishin gjashtë fëmijë dhe i pari i tyre ishte piktori Vincent. Nga këta gjashtë fëmijë, krahas fëmijës së parë, piktorit të sëmurë ishin edhe tre fëmijë të tjerë të diagnostikuar me të njëjtën sëmundje. Por “çuditërisht” asnjë nga tre të tjerët nuk manifestoi ndonjë talent artistik si vëllai i tyre i madh Vincent. Matematicieni John Nash deri në moshën 33 vjeç zhvilloi një kreativitet gjenial dhe më pas për 12 vjet u trajtua në kondita spitali për paranojë skizofrenike. Mbas trajtimit mjekësor rifilloi aktivitetin akademik për rreth 20 vjet të tjera. D.m.th kreativiteti brilant jo vetëm nuk manifestohet domosdoshmërisht në prani të sëmundjes mendore, por në të kundërt disbalanca mendore e frenon atë. Numri i të sëmurëve mendorë që nuk shfaqin kreativitet artistik është kaq shumë më i madh sa, e kundërta përbën përjashtime. Studiuesi i njohur, psikiatri Albert Rothenberg ka vënë në dukje se, te njerëzit ekscentrik me çrregullime mendore dhe tronditje emocionale ekstreme mundet që të bashkekzistojnë apo bashkëtojnë paralelisht dhuntia e talentit të shkëlqyer me sëmundjen mendore. Te njerëzit që i përmajnë paralelisht të dyja këto entitete për fat të keq cenohet ndjeshëm procesi kreativ i cili vuan dhe pëson si pasojë e interferencës dhe influencimit devijues që shkakton sëmundja nervore ndaj procesit kreativ. Duhet të kihet mirë parasysh se në shumicën e rasteve diagnostikimet psikiatrike të personave eminentë janë nxjerrë jo nga burime të sakta klinike, por nga biografitë e përgjithshme, thashethemet e paprovuara dhe interpretimet subjektiviste si të analistëve letrarë ashtu edhe të atyre psikologjikë, të cilët përshkruajnë lidhjet e hamendësuara midis konstitucionit psikologjik të artistëve dhe elementeve patologjikë të cilat i shohin të manifestuara në subjektet e veprave ose në personazhet e tyre. Këtu mund të sillet rasti i shkrimtarit Charles Dickens dhe shkrimtarit Fjodor Dostoyevsky.

Kur mendon që në shekullin e VII, biblioteka e perandorit kinez përmbante 370 000 rrotulla pergameni, ndërsa dy shekuj më vonë, në shekullin e 9-të, një nga koleksionet më të mëdha të Oksidentit që i përkisnin manastirit të Shën Gallen (Zvicër), mund të krenohet me vetëm katërqind vëllime, nuk mund të mos bësh pyetjen: Përse njerëzimi erdhi duke u diferencuar gjithmonë e më qartë në dy kultura, Lindore dhe Perëndimore. Përse kultura perëndimore pësoi një transformim umanist të jashtëzakonshëm në mijëvjeçarin e dytë? Si Individualizmi me individualitetet e spikatura brenda tij e

shndërroi një grup kolonish të shpërndara evropiane në kombin më të lirë dhe më të prosperuar në histori. Përse në Perëndim ekziston praktika e njohur institucionale që në mënyrë të vazhdueshme u jepet strehim dhe merren në mbrojtje individualitete të shquara të kulturës dhe të shkencës nga vendet e Lindjes?. Çfarë ndodhi që Shekspiri është bërë autori i parë universal duke zëvendësuar Biblën në vetëdijen civile laike?.

Kultura dhe humanizmi Perëndimore i detyrohen kryesisht kontributit të Dantes, Servantesit, Shekspirit, të cilët gjeneruan ndryshimet kulturore dhe intelektuale të njohura si Rilindja evropiane. Këta Individualitete krijuan gjuhët letrare përkatëse, krijuan dhe formësuan natyrën njerëzore ashtu si e njohim sot. Studiuesit perëndimorë të letërsisë pohojnë se gjenia e Shekspirit qëndron te mënyra unike sesi e ka përdorur gramatikën në ndërtimin e fjalive duke i shtuar anglishtes elementin poetik. Frojdi vetë besonte se ajo që e bëri Shekspirin një shkrimtar të shkëlqyer ishte aftësia e të kuptuarit të psikikës dhe të depërtuarit në subkoshiençën e njerëzore.

Shoqëritë e Lindjes janë shoqëri kolektiviste në ndryshim nga shoqëritë individualiste të Perëndimit. Kultura individualiste vlerëson si prioritar funksionin INFORMUES të komunikimit, ndërsa kulturat kolektiviste i kushtojnë një theks më të madh funksionit RELACIONAL.” Në një kontekst kulturor, “kulturat individualiste” dhe “kulturat kolektiviste” i referohen mënyrës sesi individët e shikojnë dhe e përcaktojnë veten në kontekstin e grupit - nuk i referohet sistemeve politike ose shoqërore të një vendi. Njerëzit në kulturat individualiste si Shtetet e Bashkuara dhe Evropa Perëndimore, janë shumë të pavarur dhe kanë ndjenja të forta të autonomisë brenda grupit. Në të kundërt, kulturat kolektiviste në Amerikën e Jugut dhe të Lindjes në tërësi «mbështeten në një masë të konsiderueshme te marrëdhëniet e ngushta brenda grupimeve që kujdesen për ata në këmbim të besnikërisë së verbër. Amerika është një nga shoqëritë më individualiste në botë. Në letërsinë amerikane, lufta më e madhe e njerëzve ka qenë gjetja dhe zbulimi i vetvetes përmes konceptit të Individualizmit. Individualizmi është një nga temat më të mrekullueshme të letërsisë për shkak të kontributit të tij në zhvillimin e dinjitetit njerëzor. Individualizmi është një qëndrim moral dhe një koncept filozofik që nuk do të thotë thjesht të qëndrosh vetëm. Do të thotë të zhvillosh talentet unike të dikujt dhe të jesh në gjendje t'i ndash ato për kënaqësinë e vetvetes dhe të të tjerëve. Amerikanët kanë besuar dhe besojnë se ata ushtrojnë dhe gëzojnë autonomi të

plotë gjatë jetës së tyre. Kultura Lindore përqendrohet më shumë në “kolektivizëm” që do të thotë se ata kanë familje të mëdha mbështetëse. Kultura perëndimore përqendrohet në “individualizëm” që do të thotë se çdo person duhet të sigurojë jetesën i vetëm. Ndërsa në komunizëm Partia ironizonte kapitalizmin me shprehjen: “secili për vete, Zoti për të gjithë”. Shumica e studiuesve mendojnë se, nëse me kujdes dhe pa emocion studiojmë jetën e burrave dhe grave të mëdha, zbulojmë se në mënyrë të pa ndryshueshme madhështia u zhvillua, u testua dhe u zbulua në periudhat më të errëta të jetës së tyre. Prandaj mendojnë se një nga degët më të mëdha të lumit të madhësisht është gjithmonë rrjedha e fatkeqësive.

Meqenëse individ i veprimet e vetë- interesuara të individëve krijojnë përparim shoqëror, e mira e përbashkët shërbehet më së miri kur secili individ çlirohet dhe fuqizohet të ndjekë aspiratat e veta. Studiuesi i njohur amerikan Harold Bloom nënvizon se: “Sot, nëse një roman pranohet në kanonet e kulturës amerikane atëherë konsiderohet si një kryevepër e individualizmit që inkludon dhe nënshtron qenien shoqërore dhe ambientin që e rrethon në frymën e një gjeniu të vetmuar”. Ai na kujton sesi “shkrimtarët tanë më të rëndësishëm kanë formuar vetëdijen tonë se kush jemi dhe nevojën urgjente për të qenë versione më të mira të vetvetes. Fatmirësisht shqiptarët përfaqësohen në botë me atë që konsiderohet shkrimtari më i madh i gjallë. Mbas rënies së komunizmit disa njerëz të njohur të letrave manifestuan një ndjenjë xhelozie dhe armiqësie të hapur ndaj shkrimtarit Kadare. Vepra e të cilit përbën një kreativitet sublim e njohur dhe pranuar botërisht. Njëri prej tyre nxitoi të thoshte se: “magjia e Kadaresë nuk kishte më miell për të gatuar letërsi të madhe”. Një tjetër mbas tij shkruante në gazetë: “Zblyth gjeni, ka ikur koha jote”. “Largohu nga skena, lërua vendin të rinjve” i bënte thirrje një tjetër me mendësi kolektiviste komuniste sikur shkrimtarët të ishin te radha e qumështit. Në kulturën shqiptare përbëjnë pikëllim shoqëror ndërprerja e uraganit Migjen nga sëmundja në moshë të re dhe “vdekja” për së gjalli e L. Poradecit, të dy të shquar për talentin kreativ sublim pa turbullime emocionale ekstreme. Për një kundërshti të fatit kemi dy rastet e tjera, të vlerësuar nga audienca elitare shqiptare, poeti F. Reshpja dhe kompozitori P. Jakova, te të cilët bashkëjetonte kreativiteti artistik sipëror me turbullime emocionale të rënda. Sublimiteti mund të lindë nga disa fjalë që hedhin dritë mbi një temë të tërë, ose mund të jetë rezultat i zgjerimit dhe zhvillimit të një ideje. Në këtë kontekst nuk përjashtoj mundësinë dhe praninë e momenteve

të krijimtarisë sublime në shkrimtarë, kompozitorë dhe piktorë të mirë shqiptarë që për arsye vendi nuk mund të shkruaj më gjatë.


Historia e shqiptarëve është histori e një shoqërie që në 100 vitet e fundit kaloi në 3 faza, nga fillesat e individualizmit në kohën e mbretërisë, më pas në komunizëm ekstremisht kolektivist dhe në 30 vitet e fundit në një demokaturë anarkiste. Respekti për individin përbën mungesën më të madhe në shoqërinë klanore kolektiviste shqiptare. Letërsia kujdeset vetëm për vetëpërmbytjen e mençurisë dhe bukurisë së vet, përsosmërinë e vet estetike. Në atë mënyrë, letërsia është paradoksale, njëkohësisht egoiste dhe vetëmohuese. Mbase nuk të bën një qytetar më të përgjegjshëm, por mund të të mësojë se si të fillosh të flasësh me veten tënde. Leximi i letërsisë, jo më pak se të shkruarit e saj është një reagim kundërvënës ndaj konventave asfiksuese që shoqëria konformiste i ka të nevojshme për të funksionuar. «Kreativiteti sigurisht që nuk kufizohet me rregulla ose nuk pranon kufizime që shoqëria vendos mbi ne. Pitagora ishte keqkuptuar, Sokrati, Jezusi, Luteri, Koperniku, Galileo, Njutoni gjithashtu. “Të jesh i shkëlqyeshëm është të keqkuptohesh”. Eseisti amerikan Ralph Emerson e ka përdorur këtë frazë në kontekstin se nëse njerëzit keqkuptojnë një person për shkak të ideve të tij të ndryshme nga masa, atëherë personi është, në të vërtetë, një mendimtar i shkëlqyeshëm. Kuptimi për të qenë i madh është të keqkuptohesh. James Joyce besohet se ka thënë se, gjëja më e rëndësishme në lidhje me një vepër të letërsisë, të muzikës apo të pikturës është cilësia e mendjes nga e cila buron. Njerëzit me kreativitet sublim kanë prirjen të jenë shumë individualistë, janë vetvetja në nivelin më të lartë shoqëror, vizionarët e koncepteve transformuese. Shkrimtari, kompozitori, piktori gjenial është i pazakontë me vizionin për botën dhe stilin e të shprehurit. Nuk e riprodhon botën por e transformon atë. Mendoni për një moment sesi gjatë një shekulli impresionistët kaluan nga skandali i salloneve në posterat e dhomave të fjetjes. Bashkëkohësve të cilëve u drejtohet janë pak sepse ai nuk po i jep masës atë që është mësuar të marrë gjithmonë. Duhet të kalojë kohë që njerëzit të mësojnë mënyrën e tij të re për të parë dhe për të pranuar se ka edhe një shprehje tjetër të së vërtetës. Kërkohet një nivel i caktuar asimimi dhe kultivimi kulturor për të menduar dhe shikuar si shkrimtari elitar. Gjë që zotërohet nga një pakicë lexuesish. Natyrisht si autor ju dëshironi që lexuesi të ketë një bagazh kulturor për të kuptuar idenë, prioritetet apo tezën e autorit.

Dymijë vjet më parë Longinus kërkonte që audienca “duhet të jetë e çliuar nga mendimet e ulëta dhe vulgare që shoqërojnë përgjithësisht njerëzit e munduar nga puna fizike në natyrë.

Asnjëherë në historinë e kulturës botërore nuk ka pasur mungesë të “shkrimtarëve, piktorëve, kompozitorëve keqdashës të vërtetë e xhelozë” të cilët nga pusia e ngritur me kujdes godasin armiqësisht veprat e krijuesve më të mirë.

Psikologët njohin e pranojnë ndonjë anë pozitive të zilisë e cila në shumicën e rasteve manifestohet me ndjenja që rrezikojnë stabilitetin emocional të një individ, i cili mund të sjellë pasoja të rrezikshme për rrethin e njerëzve pranë tij. Nuk mund të mos bëhet pyetja: kur ndodh që xhelozia arrin një pikë të rrezikshme? Ndoshta kjo ndodh atëherë kur fillojmë që të kujdesemi më shumë për shkatërrimin e diçkaje sesa për procesin vetjak të krijimit.

Psikiatri Albert Rothenberg thotë: “Ka vetëm dy mënyra për të reaguar ndaj njerëzve me kreativitet të lartë artistik; ne ose i adhurojmë ata ose jemi xhelozë”.







# PËRKTHIMET SI FRYMË E KOHËS SONË?

nga Tim Parks

A tregojnë qasjet bashkëkohore ndaj përkthimit diçka për kohën tonë? Samuel Johnson-i ishte i pari që na dha një histori të shkurtër të pikëpamjeve për përkthimin, duke vërejtur se si disa në epoka ka më shumë përkthime, ndërsa në të tjera shumë pak, dhe se si secila epokë priret të përkrah kritere të ndryshme për përkthimin. Ai vëren se grekët nuk përkthenin tekste nga egjiptianët, romakët e shquar prireshin të mësonin greqisht dhe ta përjetonin drejtpërdrejt gjuhën, në vend që të lexonin versionet në latinisht: “arabët ishin kombi i parë që ndjeu aromën e përkthimit”, kur pushtuan pjesë të perandorisë greke dhe u përpoqën t’i përvetësojnë vetë njohuritë për për ta.

Duke kaluar në kohët moderne, Johnson-i analizoi mënyra të ndryshme para dhe pas periudhës së Restaurimit në vitet 1660-të. Shkrimtarët para Restaurimit, sipas tij, “kishin të paktën nivelin e aftësisë së të mësuarit në të njëjtin nivel me aftësitë gjeniale intelektuale” kur merreshin me tekste klasike, dhe nëse nuk mundeshin “të shfaqnin elegancë dhe të bënin shpërndërrimin e shpirtit”, ata e kompensonin këtë duke përkthyer shumë, dhe

“fjalë për fjalë, në mënyrë që besnikëria të mund të strehonte papërsosmërinë ose ashpërsinë”. Johnson-i mëton nga ana tjetër se përparësi e përkthimeve gjatë Restaurimit, ishte të paturit “rrallë e pikëpamjeve të cilat ishin jo të thelluara dhe gati sipërfaqësore”, dhe kjo fshehu “dëshirën e përkthyesve për ngjyrat e një imagjinatë të shpenguar” duke shpresuar se “lexuesit e tyre do ta pranonin shkëlqimin e dijes duke e parë mosdijen dhe gabimin si pasojë e padurimit të një mendjeje që nxitonte pa u ndalur tek vështirësitë, pasi ishte kaq e lartësuar sa nuk merrej me vogëlsirat”.

Nga periudha romantike e në vazhdim, vëzhgime të tilla për mënyrën se si është përkthyer në kohë dhe kultura të tjera u bë e zakonshme, si me kritikët anglezë ashtu edhe me ata gjermanë që theksonin se sa pa mëshirë e thjeshtëzonin francezët çdo tekst të huaj, sado i ndërlikuar dhe veçantë që ishte duke ia përshtatur mënyrës së tyre të shkruarit. U kuptua menjëherë se ky lloj brendësimi i skajshëm i përkthimeve kishte të bënte me besimin tek epërsia e kulturës franceze, pavarësisht se filozofi dhe kritiku Johann Gottfried Herder (1744–1803), studiuesi biblik Friedrich Schleiermacher (1768–1834), dhe studiuesi i gjuhës gjermane Wilhelm von Humboldt (1767–1835)

besonin se ky ishte shkaku pse francezët nuk mësuan asgjë nga përkthimet e shumta që bënë.

Schleiermacher-i besonte se përkundrazi, ishte fati i popullit gjerman që të përfshinte gjuhësisht, dhe të ruante në qendrën gjeografike dhe në zemrën e Evropës, të gjitha thesaret, si të artit të huaj ashtu edhe të artit dhe dijes së vet, në një tërësi historike të mrekullueshme, në mënyrë që me ndihmën e gjuhës gjermane të gjithë të mund të shijonin, po aq pastër dhe aq përsosmërisht sa një i huaj, të gjitha bukuritë që kanë krijuar epokat. Kjo do të bëhej, sipas tij, me një qasje rrënjësisht jo-brendësuese, duke e çuar sa më larg që të ishte e mundur drejt “të huajës” së së tekstit të huaj, diçka për të cilën gjermanishtja ishte e pajisur më mirë se sa gjuhët e tjera, siç besonte ai. Poeti dhe kritiku Friedrich Schlegel (1772–1829) pajtohej me të: “Nga të gjitha gjuhët në të cilat janë bërë përkthimet e Homerit qoftë në prozë qoftë në vargje, duke nisur nga gjuha siriane deri në gjuhën angleze, asnjë s’mund t’i afrohet tekstit origjinal me një besnikëri të tillë fatlume si përkthimi në gjuhën gjermane”.

Kështu, ndërsa francezët besonin se stili francez ishte tashmë modeli i duhur për të përshtatur gjithçka, gjermanët besonin se gjuha e tyre ishte instrumenti më elastik për të pasqyruar çdo stil.

Në vitin 1882, Friedrich Nietzsche vërejtë se shkalla e të kuptuarit të historisë në çdo epokë mund të nxirret nga mënyra në të cilën kjo epokë bën përkthime dhe përpiket të përthithë epokat dhe librat e mëparshëm. Sa më shumë që një kulturë vetëdijësohet për ndryshimet reale të kulturave dhe kohërave të tjera, siç kishin bërë gjermanët, aq më pak ka të ngjarë, shkroi ai, që të përpiqesh ta “bëhesh padron” i tjetrit siç bënë “në epokën e Korneille...kur francezët u bënë padron të antikitetin romak”.

Por çfarë mund të themi për kohën tonë dhe kulturën tonë? A po e thjeshtëzojmë gjithçka që përkthejmë në anglishten standarde, çfarëdo qoftë ajo? Apo po përpiqemi të afrohem me të huajën e teksteve të huaja?

Ajo që tërheq vëmendjen e çdokujt që dëgjon diskutimet e çështjeve të tilla në botën e përkthimit në radhët e akademikëve, përkthyesve dhe botuesve të përkthimeve, është larmia e madhe e mendimeve dhe qasjeve të mbrojtura, eklektizmi i skajshëm dhe paqartësia e përgjithshme për ato që kërkohen në përkthim. Duke rishqyrtuar librat e punumërt mbi përkthimin gjatë tridhjetë viteve të fundit, kam arritur në përfundimin se nuk ka ndonjë qasje mbizotëruese në epokën tonë: të saktë dhe të pasakta, të rrjedhshme dhe të ngathëta, të gjitha përkthimet duket se vlerësohen po aq sa janë kritikohen (më





shumë e para se sa e dyta). Sidoqoftë, dy pikëpamje shfaqen si të pranuar botërisht, dhe nuk besoj se kanë nevojë për shpjegim të hollësishëm.

E para, përkthimi është gjithmonë një gjë e mirë, në aspektin politik, etik, estetik. Përkthyesi bashkon kulturat, nxit mirëkuptimin, lufton nacionalizmin, jep ndihmesë në shmangien e konfliktit. Është diçka që duhet ta bëjmë të gjithë, të ndihemi mirë që e bëjmë, dhe t’ia njohim meritat njëri-tjetrit për këtë.

E dyta, përkthimi letrar jo vetëm që është plotësisht i mundur, por, deri diku në mënyrë të habitshme, shpesh përputhet plotësisht madje edhe e përmirëson cilësinë e origjinalit. Njoftimet për shtyp për titujt në garën finale për çmimet e përkthimit që jepen nga Çmimet e Përkthimit për autorët e vitit 2019 në Mbretërinë e Bashkuar përdorin dhe përsëritin shumë herë fjalën “rrok” për të sugjeruar që përkthimet fituese s’kanë lënë gjë të pashprehur nga origjinali, prandaj lexuesit mund të ndjehen të sigurt se s’humbasin asgjë duke lexuar përkthimin. Për njërin nga përkthimet thuhet se ai “është në të njëjtin nivel, dhe nganjëherë madje e tejkalon origjinalin”, ndërsa një përkthim tjetër vlerësohet për mënyrën se si “rrok muzikën e sferave tokësore [të origjinalit], duke na treguar se përkthimi është në të vërtetë, gjuha jonë universale”.

Po të kthehemi në botën akademike, është befasuese se sa rrallë përkthimet krahasohen me kujdes me origjinalin, dhe sa pak flitet për komptencën gjuhësore. Në vend të kësaj, nëse marrim parasysh llojin e teksteve që përfshihen vazhdimisht në antologjitë e teorisë së përkthimit duke nisur nga leksioni i Schleiermacher-it “Për metodat e ndryshme të përkthimit” (1813), pastaj “Për detyrën e përkthyesit” (1923) i Walter Benjamin-it, “Përkthimi: letërsi dhe letrat” (1971) i Octavio Paz-it dhe “Des Tours de Babel” (1985) i Zhak Derridas, nuk është e vështirë të shihet se si një idealizëm i përhapur romantik, madje edhe misticizëm do të thosha, garanton këto panegjerik të papërmbajtshëm bashkëkohor sipas të cilëve përkthimet përmirësojnë origjinalin dhe shpëtojnë njerëzimin.

E kemi dëgjuar tashmë Schleiermacher-in duke folur mbi ëndrrën e tij për “një tërësi të mrekullueshme historike”, në të cilën çdo libër i shkruar mund të shijohet nga të gjithë. Ndërs Benjamin-i shkruan: “Në përkthim origjinali krijohet në një mjedis gjuhësor më të lartë dhe më të pastër...në mbretërin e paracaktuar, deri më tani të paarrtshme të pajtimit dhe përmbushjes së gjuhëve...” Dhe përsëri: “Është detyrë e përkthyesit të jap në gjuhën e vet atë gjuhë të kulluar, e cila është nën pushtetin magjepsës të një gjuhe tjetër, ta çliroj atë gjuhë të burgosur në një vepër tjetër duke e rikrijuar atë vepër”.

Derrida, pasi i jep peshë të madhe mitit biblik të Kullës së Babelit, arrin në këtë përfundim:

“Nuk ka asgjë më serioze se sa një përkthim... Sepse nëse struktura e origjinalit [veprës] shënjohej nga nevoja për t’u përkthyer, kjo ndodh sepse me vendosjen e këtij rregulli, origjinali fillon t’i ketë detyrime, edhe përkthyesit. Origjinali është debitori i parë, kërkuesi i parë i cili fillon me pranimin e asaj që i mungon dhe thirrjen për përkthim”.

Ky arsyetim misterioz se çdo teksti të shkruar menjëherë “i mungon” plotësia sepse nuk është i pranishëm në të gjitha gjuhët e tjera të botës është kthyer në elementin kryesor të teorisë së përkthimit, ndoshta sepse duke e lartësuar përkthimin në nivelin e një detyrimi kategorik, ai vetvetiu nënkupton një rëndësi të madhe dhe solemne në një fushë që ishte shpërfillur në masë të madhe në universitete deri rreth njëzet vjet më parë. Në përgjithësi, është befasuese se sa respekt tregohet ndaj këtyre teksteve të çuditshme dhe të ngatërruara.

Octavio Paz-i, megjithëse nuk i arrin asnjëherë

lartësitë marramendëse të Benjamin-it dhe Derrida-s, është po aq pozitiv dhe prerazi universalist: “Përkthimi brenda së njëjtës gjuhë nuk është thelbësisht i ndryshëm nga përkthimi midis dy gjuhëve, dhe historitë e të gjithë popujve ngjajnë me përvorin e fëmijës...” Dhe vijon: “Megjithëse gjuha nuk është universale, gjuhët megjithatë janë pjesë e një shoqërie universale në të cilën, pasi të jenë tejkaluar disa vështirësi, të gjithë njerëzit mund të komunikojnë dhe të kuptojnë njëri-tjetrin. Dhe ata mund ta bëjnë këtë sepse në çdo gjuhë njerëzit gjithmonë thonë të njëjtat gjëra”.

Çdo bisedë për papërkthyeshmërinë, për Paz-in, mund të jetë vetëm rezultat i një “shprehje e pavullnetshme verbale”, ose e kapjes “në grackën e subjektivizmit”. “Përgjatë epokave”, vazhdon ai, “poetët evropianë, dhe tani edhe poetët e të dyja gjysmave të kontinentit amerikan, kanë shkruar të njëjtën poezi në gjuhë të ndryshme ... një simfoni në të cilën improvizimi është i pandashëm nga përkthimi dhe krijimi është i padallueshëm nga imitimi”

Në thelb, atëherë, të gjitha këto qasje në përkthim janë shkaku i oreksit të epokës për globalizim dhe ushqejnë një *zeitgeist* që përkrah pikëtakimin dhe

e pakapshme. Dhe, megjithëse Schleiermacher-i shpërfaq vizionin e tij për një gjuhë gjermane, e cila i përshtatet në një mijë mënyra për “t’i bërë bashkë dy njerëz plotësisht të pa lidhur me njërin tjetrin”, autorin origjinal dhe lexuesin e përkthimit, ai na kujton megjithatë se në rastin më të mirë, lexuesit thjesht do të “kapin dritëzën...e gjuhës origjinale dhe borxhin e veprës ndaj saj”. Sigurisht që ky është pozicioni që mban Nabokov-it tek “Problemet e përkthimit: Onjegini në anglisht”, ku ai sugjeron, për shkak se ishte koleksionist, se përkthimi ka të njëjtën lidhje me origjinalin, siç ka një flutur e balsamosur në kutinë e një koleksionisti me një flutur në gjendjen e saj natyrore.

Analogjia e Nabokovit është shkurajuese dhe mendoj e pasaktë. Ka mjaft përkthime shumë të gjalla që “fluturojnë” përreth nesh. Por ajo që përbashkon si mendimin e tij ashtu edhe të Schleiermacher-it është të kuptuarit e përkthimit si një ftesë për një takim midis mendësive krejt të ndryshme, kulturave të ndryshme, gjuhëve të ndryshme, takim i cili është emocionues po aq sa i vështirë.. “Të gjithë njerëzit janë nën ndikimin e gjuhës që flasin”, pranon Schleiermacher-i, “kështu që është e pamundur të



Një vizatim i Samuel Johnson duke ecur me James Boswell, botuar te *The Graphic*, Dhjetor 1884

larminë kulturore, në të cilën çdo individ mund të zotërojë plotësisht çdo shprehje kulturore, dhe s’ka asnjë ndryshim dhe moskuptim të thellë.

A ka ndonjë problem këtu? Apo shqetësimi im është thjesht i tepërt? “Për njëmijë ankues qaramanë, shkruante Samuel Johnson-i, duke mbrojtur përkthimin e Homerit nga Alexandër Pope, mjafton një përgjigje: qëllimi i një shkrimtari është të lexohet, dhe kritikë që mund ta prishin kënaqësinë e të lexuarit duhet të flaken mënjanë”. Ky duket një qëndrim bindës, urues, jo pa kuptim, veçanërisht kur e krahasojmë me këmbënguljen e Johnson-it për dituri akademike dhe saktësi. Unë jam po aq i gatshëm sa kushdo për një botë ku gëlojnë përkthimet. Në fund të fundit, unë vetë kam qenë përgjegjës për shumë prej tyre.

Por le të risjellim në kujtesë se, pavarësisht nga entuziazmi i tyre, teoricienët që përmenda më sipër, me përjashtim të mbase të Paz-it, janë sidoqoftë të vetëdijshëm për një “të ndryshme” në një tekst të huaj e cila i bishtnon përkthimit, është e papushtueshme,

mendosh me qartësi të plotë çdo gjë që qëndron matanë kufijve të saj”.

Ajo që është emocionuese në lidhje me përkthimin nuk është nocioni që ai mbart njëqind për qind origjinalin, diçka që Schleiermacher-i nuk do ta kishte pranuar kurrë, ose që e gjithë bota e ndjenjës njerëzore mund të jepet në idiomën e gjuhës tonë, fantazi kjo e cila thjesht bëhet burim vetëkënaqësie, por nxitja për të ecur përpara, ose të paktën për t’u vetëdijësuar për atë që nuk e dimë, për përkthimin si një thirrje për t’u zgjuar dhe një instrument që na ysht për më shumë përpjekje, dhe nuk na detyron të ulemi për duartrokitur një tjetër fenomen të suksesshëm botimi në mbarë botën.

Për ta mbyllur me një provokim, ndoshta ia vlen të vëreni që entuziazmi aktual për përkthimin letrar në botën anglo-saksone është shtuar njëkohësisht me rënien e madhe në nivelin e mësimi të gjuhës.

*The New York Review of Books*  
Përktheu: Granit Zela





AZEM SHKRELI  
lirikë me shi

OnufriPoezi